

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5894
E enjte, 3 tetor 2019
çmimi 0.40 €

FLET PËR "EPOKËN E RE",
KAQUSHA JASHARI ■ FAQE 4-5

**Kuvendit
i duhen
deputetë me
përvojë
shumëvjeçare**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KANDIDATËT PËR KRYEMINISTËR TË KOSOVËS TË GATSHËM PËR TA DREJTUAR
DIALOGUN KOSOVË - SERBI ■ FAQE 7

DIALOGU ME SERBINË, PJESË E RËNDËSISHME E FUSHATËS ZGJEDHORE

Pesë kandidatët për kryeministër të Kosovës pothuajse në çdo tubim elektoral po e përmendin çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Të gjithë kanë konfirmuar se do të jenë të

gatshëm ta udhëheqin këtë proces pas zgjedhjeve nëse marrin besimin e qytetarëve të Kosovës, duke premtuar se kufijtë e Kosovës në këtë proces do të jenë të paprekshëm.



Ndonëse janë zotuar se nuk do të ketë kompromise të reja me Serbinë, ata nuk kanë shprehur qëndrime të njëjta rreth çështjes së taksës ndaj mallrave serbe

OPINION

**PËRJETIMET E TË BËRIT
FUSHATË ME PULLË
TË KUQE PËR ZGJEDHJE,
PA ZGJIDHJE! F. 10**

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



**FILLON FUSHATA
SENSIBILIZUESE
'MA THUAJ ME KOHË' F. 2**

**KOSOVA BËHET ME
KONSULLATË NË SHKUP F. 2**

EKONOMI

**'ZIRAAT BANK' HAPI DEGËN
E KATËRT NË FERIZAJ F. 9**

**EKONOMIA NË SHOIPËRI U RRI
2.31 PËR QIND, NDIKIM NEGATIV
ENERGJIA DHE BASTET F. 9**

SPORT



**LLAPI FITON DERBIN NDAJ
'NIKLI', DUKAGJINI SHIJON
FITOREN E PARË NË SUPERLIGË**

F. 18

FUSHATA PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT



**Limaj: Qytetarët e
Kosovës po duan bashkim
për shtetin**



**Pacoli në Gjilan
premtonte vende të
reja të punës**



**Kurti premtonte një të punësuar
për çdo familje që është në
skemë sociale**



**Haradinaj në Drenas:
Ruajeni votën**



**Osmani në Podujevë: Na nevojitet
përkrahje e fuqishme që ta
bëjmë ndryshimin e madh**



**Veseli: Kosovës i duhet një
qeveri e udhëhequr nga
PDK-ja**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Kosova bëhet me konsullatë në Shkup

PRISHTINË, 2 TETOR - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka bërë me dije se të mërkurën është hapur Konsullata e Kosovës në Shkup. Dedaj ka thënë se hapja e shërbimit konsullor

në Shkup është një hap i rëndësishëm për misionin diplomatik të Kosovës. "Urime, Kosovë! Sot, më 2 tetor 2019, bëme promovimin para gazetarëve, të shërbimit konsullor të Ambasadës së Republikës së Kosovës në

Shkup, si dhe ambientet në ndërtesën e re të këtij shërbimi të rëndësishëm për misionin diplomatik të Republikës së Kosovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut!", ka shkruar Dedaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Trumpi: Hetimi për shkarkim është një grusht shteti

WASHINGTON, 2 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, kritikoi hetimin për shkarkimin e tij, duke e quajtur atë një "grusht shteti". Komentet e tij vijnë në kohën kur krerët e disa komisioneve në Dhomën e Përfaqësuesve e kanë akuzuar sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, për bllokimin e përpjekjeve të tyre për të mbledhur dokumente dhe intervistuar dëshmitarët. "Çdo ditë e më shumë po arrij në përfundimin se ajo që po ndodh nuk është një hetim për shkarkim. Ky është një grusht shteti i planifikuar për t'ia hequr fuqinë popullit, të drejtën e tij për të votuar, lirinë e tij, amendamentin e dytë të Kushtetutës, fenë, ushtrinë, murin në kufi dhe të drejtat që ia ka dhënë Zoti si qytetarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", shkruante Trumpi në një postim në "Twitter".

Demokratët që kanë shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve po vazhdojnë hetimin për të parë nëse mund të ngrenë zyrtarisht akuza për shkarkimin e Trumpit, bazuar në parimin kushtetues që largon zyrtarët që angazhohen në akte "tradhtie, marrje rryshfeti, apo krime të tjera të mëdha, e



kundërvajtje".

Inspektori i përgjithshëm i Departamentit të Shtetit pritet të takohet këto ditë me stafin e komisioneve të Mbikëqyrjes, Punëve të Jashtme e Zbulimit të të dyja dhomave të Kongresit për të diskutuar mbi dokumentet që ligjvënësit kanë kërkuar, ndërsa

hetojnë telefonatën e muajit korrik mes presidentit Trump dhe homologut të tij të Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy.

Komisionet e Zbulimit, Mbikëqyrjes dhe Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve kanë kërkuar ta dëgjojnë të mërkurën dëshminë

e ish-ambasadores amerikane në Ukrainë, Marie Yovanovitch, por seanca është shtyrë për javën tjetër. Ndërkohë sot (e enjte) ish i dërguari amerikan në Ukrainë, Kurt Volker, pritet të dëshmojë përpara këtyre komisioneve. Zhvillimet vijnë pas ankesës së paraqitur nga një informator në

të cilën ai shpreh shqetësimin se Trumpi po kërkonte ndërhyrje të huaj në zgjedhjet e vitit 2020 duke i kërkuar Ukrainës ta hetojë kandidatin demokrat Joe Biden. Por Trumpi ka thënë se ai nuk ka bërë asgjë të keqe gjatë diskutimeve që ka pasur me Zelenskiy.

Pendarovski: Vizita e Pompeo, simbolikë e kthimit të madh të ShBA-së në Ballkan

SHKUP, 2 TETOR - Vizita e Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi, nënkupton paralajmërimin e Uashingtonit për praninë më të madhe në Ballkan. Kështu kanë deklaruar në Shkup presidentët e dy vendeve, Stevo Pendarovski dhe Millo Gjukanoviq.

"Mendoj se vizita është shumë e mirë në disa aspekte. Vizita e fundit e një niveli kaq të lartë amerikan ka ndodhur para 19 vjetëve nga ish-sekretari Colin Powell. Kjo nuk është një vizitë kurtuazie. Bazuar në shtetet ku do të qëndrojë, në Itali, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Greqi, nënkuptohet se Pompeo nuk

vjen në rajon për zgjidhjen e sfida, por që t'u japë mirënjohje atyre për punën e bërë. Vizita e tij është simbolikë për kthimin në dyer të mëdha të ShBA-së në Ballkan. Çështjet kyçe te ne janë zgjidhur me mbështetjen e ShBA-së, pra ato nuk do të mund të zgjidheshin pa përfshirjen amerikane në këto procese", ka deklaruar presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, pas takimit në Shkup me presidentin e Malit të Zi, Millo Gjukanoviq. Edhe presidenti malazias tha se sekretari Pompeo gjatë vizitës në rajon do të përcjellë mesazhe të qarta për mbështetjen e fuqishme amerikane.

Gjukanoviqi ka thënë se e ardhmja e Ballkanit është në Bashkimin Evropian dhe në NATO, ndërsa ka ofruar mbështetjen e vendit të tij për inkuadrimin e Maqedonisë së Veriut në këto institucione. "Në Mal të Zi jemi bindur se pasiguria me të cilën, për fat të keq, njihet Ballkani, është pasojë e zhvillimeve demokratike të rajonit. Përgjigjja e gjithë kësaj duhet të jetë integrimi, arritja e kualitetit evropian edhe për popujt tanë. Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe jemi në bisedime me BE-në. Mendoj se është me rëndësi që ta mbështesim edhe Maqedoninë e Veriut në këtë rrugë", ka deklaruar Gjukanoviqi. Sa iu përket debateve me



Bullgarinë, e cila i jep mbështetje integritit evropian të Maqedonisë së Veriut, por jo pa kushte, presidenti Stevo Pendarovski beson se Sofja nuk

do ta blloktojë datën e bisedimeve, ndërsa çështjet kontestuese nga e kaluara historike, sipas tij, do të zgjidhen në kuadër të bisedimeve me BE-në.

Kandidatët për kryeministër të Kosovës të gatshëm për ta drejtuar dialogun Kosovë - Serbi

Dialogu me Serbinë, pjesë e rëndësishme e fushatës zgjedhore

Pesë kandidatët për kryeministër të Kosovës pothuajse në çdo tubim elektoral po e përmendin çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Të gjithë kanë konfirmuar se do të jenë të gatshëm ta udhëheqin këtë proces pas zgjedhjeve nëse marrin besimin e qytetarëve të Kosovës, duke premtuar se kufijtë e Kosovës në këtë proces do të jenë të paprekshëm. Ndonëse janë zotuar se nuk do të ketë kompromise të reja me Serbinë, ata nuk kanë shprehur qëndrime të njëjta rreth çështjes së taksës ndaj mallrave serbe



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 TETOR - Prej fillimit të fushatës zgjedhore dialogu me Serbinë ka qenë një ndër temat kryesore për të cilën kanë folur kandidatët për kryeministër në tubimet elektorale. Ata kanë rikonfirmuar qëndrimin për ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës në këtë proces, duke u shprehur të gatshëm ta drejtojnë këtë proces. Ndonëse janë zotuar se nuk do të lëshojnë pe në raport me Serbinë, nëse i fitojnë zgjedhjet e 6 tetorit ata kanë shprehur mendime të ndryshme rreth taksës ndaj mallrave serbe.

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se së bashku me Amerikën do ta mbrojnë Kosovën nga Serbia. "Së bashku me Amerikën, Kosova është më e fortë dhe më e sigurt në rrugën e saj të suksesit. Së bashku me Amerikën ne do të fitojmë ulëse në Kombet e Bashkuara dhe do ta ruajmë integritetin dhe sovranitetin institucional e territorial të Kosovës", ka deklaruar Veseli në tubimin elektoral në Gjilan. Kandidatja nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për kryeministër, Vjosa Osmani, ka thënë se nuk do të ikë nga dialogu me Serbinë siç ka bërë kryeministri në dorëheqje. Gjatë

një tubimi elektoral në Suharekë, ajo ka thënë se vetëm me LDK-në kufijtë e Kosovës janë të sigurt. "Kufijtë e Kosovës me LDK-në janë të sigurt. Unë nuk do t'i ik dialogut dhe përgjegjësisë siç ikën frikacakët e tanishëm dhe e lanë Kosovën në duart e Thaçit. Do ta përfaqësoj Kosovën dhe do ta mbroj Kushtetutën me çdo çmim", ka thënë Osmani.

Gjatë fushatës ajo ka folur edhe për taksën, duke thënë se me ardhjen e saj në qeveri do ta zëvendësojë atë me reciprocitet të plotë. Por, kandidati për kryeministër i koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, ka kundërshtuar çdo përpjekje për heqjen e taksës. Në një tubim elektoral në Gjilan, ai ka thënë se rivalët e tij politikë po nxitohen me këto qëndrime. "Albin Kurti ishte këtu në Gjilan apo Lipjan dhe tha se taksa nuk është politikë e imja. Vjosa tha se e heq për pesë minuta, Kadriu tha se e suspendon menjëherë. Shikoni, ne po mbesim pa instrumentet e nevojshme, pa kundërvlerën e nevojshme për marrjen e njohjes. Më 6 tetor ne ia mundësojmë Kosovës me votën për 119, për t'i ratifikuar vendimet e marra, mos të kthehemi prapa dhe të mund të fokusohemi në punë", ka deklaruar Haradinaj.

Prej fillimit të fushatës zgjedhore, kandidati për kryemi-

nistër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, që nga fillimi i fushatës ka thënë se është kandidati më i duhur për ta udhëhequr këtë proces. Madje ai u ka bërë thirrjeve të gjithë kandidatëve për kryeministër që të zotohen para zgjedhjeve se do të jenë konstruktivë pas zgjedhjeve në dialogun për Serbinë. "Po futemi në një moment të rëndësishëm të këtij procesi zgjedhor, i cili do ta përcaktojë qartë kahun e vendit tonë për disa vjet, ose për 100 vjetët e ardhshëm. Është shumë e mundur që parlamenti që do të votohet më 6 tetor do ta votojë marrëveshjen me Serbinë. Shumë e mundur që qeveria e cila do të dalë nga këto zgjedhje do ta negociojë marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Andaj, kjo nënkupton që duhet të jeni të kujdesshëm kë po e votoni", ka theksuar Limaj në fillim të fushatës.

Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se subjek-

tet politike gjatë fushatës duhet ta rikonfirmojnë edhe një herë qëndrimin kundër ndryshimit të kufijve Kosovë - Serbi. "Mendoj se ka nevojë të rikonfirmohet qëndrimi i partive politike rreth çështjes së kufijve dhe se në dialog me Serbinë parim kryesor të jetë njohja reciproke mes dy shteteve në kufijtë e tashëm të Kosovës. Po ashtu, procesi i dialogut duhet t'i ketë vijat e kuqe siç kanë qenë prej vitit 2011, kur e kam udhëhequr unë këtë dialog", është shprehur ajo. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë me dije se ndër prioritetet kryesore të qeverisë së re do të jetë dialogu me Serbinë. Këtë e ka konfirmuar edhe Mathew Palmer, i dërguar i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", ai ka deklaruar se qeveria e ardhshme e Kosovës duhet të jetë e gatshme ta pezullojë taksën.

Edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se subjek-

Prokuroria Speciale ngre aktakuzë ndaj personit që ka 'përgatitur vepra terroriste'



PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Prokuroria Speciale në Kosovë ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit S. A. për shkak të veprave penale, "përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, 'mashtrim' si dhe 'mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". Në një komunikatë për media

është thënë se pjesë e pakos ka qenë një armë dhe ilaçe të ndryshme, bashkë me një pamflet me logo të Serbisë, "përmbajtja e së cilës ka bërë thirrje për të dëmtuarin dhe qytetarët e tjerë serbë si, M. R., B. P., S. P., M. N., M. P. dhe D. P., që të bartnin armë nga depot e ndryshme të Mitrovicës, me qëllim që të ndërmerren sulme dhe të përdoret dhunë fizike ndaj qytetarëve serbë në

mënyrë që para bashkësisë ndërkombëtare t'i fajësojnë shqiptarët". Në komunikatë Prokuroria Speciale ka thënë se i pandehuri nga viti 2017 ka mashtruar në vazhdimësi shumë qytetarë me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore. Ai është prezantuar kinse ka pozita të ndryshme qeveritare me qëllim të manipulimit të qytetarëve serbë.

Flet për "Epokën e re", Kaqusha Jashari

Kuvendit i duhen deputetë



Kandidatja për deputete të Kuvendit të Kosovës nga koalicioni AAK-PSD, Kaqusha Jashari, ka shprehur optimizëm se do ta marrë besimin e qytetarëve për t'u zgjedhur deputete. Ajo ka thënë se do të ishte në të mirë të Kuvendit që ta ketë një deputete me përvojë shumëvjeçare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jashari ka thënë se PSD-ja e ka prioritet mirëqenien e qytetarëve. Sipas saj, koalicioni AAK-PSD e ka programin më të mirë për shtetin dhe qytetarët. Ajo ka premtuar se nëse bëhet deputete do të jetë besnike e realizimit të këtij programi. Jashari ka folur edhe për dialogun, me ç'rast ka thënë se përfundimi i këtij procesi nuk do të jetë i lehtë. Sipas saj, taksa duhet të mbetet në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga Serbia

Sipas Jasharit, do të ishte në të mirë të Kuvendit që ta ketë një deputete me përvojë shumëvjeçare. "Secili kandidat i hyn garës me synimin për fitore, prandaj nuk do të kishte kuptim që të kandidohesh dhe të angazhohesh nëse nuk beson në vete se do të fitosh. Mendoj se është mirë që Kuvendi ta ketë një person siç jam unë me përvojë shumëvjeçare", është shprehur ajo.

Ajo ka thënë se PSD-ja e ka prioritet mirëqenien e qytetarëve dhe, sipas saj, koalicioni AAK-PSD e ka programin më të mirë për shtetin dhe qytetarët. Jashari ka premtuar se nëse zgjedhet deputete do të jetë besnike e realizimit të këtij programi. "PSD-ja dhe unë e kemi prioritet mirëqenien e qytetarëve. Koalicioni AAK-PSD e ka programin më të mirë. Të dy partitë për çështje ekonomike, sociale, për

arsimin dhe për shëndetësinë kanë mirëkuptim 100 për qind. Nëse unë do ta marr besimin e qytetarëve për t'u bërë deputete, premtoj se do të jem besnike e realizimit të këtij programi", ka theksuar ajo. Jashari ka folur edhe për dialogun, me ç'rast ka thënë se përfundimi i këtij procesi nuk do të jetë i lehtë. Sipas saj, taksa duhet të mbetet në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga Serbia. "Procesi i dialogut duhet të përfundojë sepse kjo është në interes të Kosovës. Po ashtu, është edhe në interes të Evropës që të ketë stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Mirëpo nuk mendoj se do të jetë i lehtë aspak përfundimi i këtij procesi, megjithatë nuk duhet bërë kompromise në dëm të vendit tonë", ka deklaruar Jashari.

"Epoka e re": Znj. Jashari, pse vendoset që t'i ktheheni poli-

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 TETOR - Kandidatja për deputete nga radhët koalicionit AAK-PSD, Kaqusha Jashari, ka thënë se nuk ka nevojë të llobojë për mbledhje të votave meqë është e njohur për opinionin kosovar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ajo ka thënë se e ka marrë besimin e qytetarëve shumë më herët, meqë e ka pasur të qartë qëndrimin për Kosovën e pavarur. "Nëpër këto tubimet po shkoj për t'u takuar me njerëz e jo për të lobuar sepse nuk kam nevojë. Mua më njeh opinioni kosovar dhe besimin e qytetarëve e kam fituar shumë më herët, meqë e kam

pasur shumë të qartë qëndrimin për Kosovën, për ruajtjen e identitetit të Kosovës dhe për Kosovën e pavarur", ka deklaruar Jashari, duke shtuar se është në pension, por për politikë nuk ka moshë. Ajo ka shprehur optimizëm se do ta marrë besimin e qytetarëve për t'u bërë deputete e Kuvendit.

me përvojë shumëvjeçare

tikës dhe të kandidoni për deputete?

Jashari: Siç e dini, kjo nuk është hera e parë që unë garoj për deputete sepse jam pjesë e Partisë Socialdemokrate që nga themelimi. Në vazhdimësi kemi marrë pjesë në zgjedhje, por nuk kemi pasur mundësi të depërtojmë. Vetëm kur kemi qenë pjesë e koalicionit me PDK-në kemi hyrë në Kuvend dhe unë kam qenë deputete në mandatin e nënshkrimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Jam në pension, por për politikë nuk ka moshë. Në këto zgjedhje, përveç këtyre socialdemokratëve të rinj, garojmë edhe ne si të themi socialdemokratët e mëherëshëm, pra unë, Shqipe Kastrati dhe Eleonora Çeku.

"Epoka e re": Meqë jeni pensioniste, sa është sfiduese që të dilni në terren për të lobuar për vota?

Jashari: Një për këto tubimet po shkoj për t'u takuar me njerëz dhe jo për të lobuar sepse nuk kam nevojë. Mua më një opinionin kosovar dhe besimin e qytetarëve e kam fituar shumë më herët meqë e kam pasur shumë të qartë qëndrimin për Kosovën për ruajtjen e identitetit të Kosovës dhe për Kosovën e pavarur.

"Epoka e re": Besoni se do të bëheni deputete dhe nëse po, çka do t'i ofroni Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve?

Jashari: Secili kandidat i hyn garës me synimin për fitore, prandaj nuk do të kishte

kuptim që të kandidohesh dhe të angazhohesh nëse nuk beson në vete se do të fitosh. Mendoj se është mirë që Kuvendi ta ketë një person siç jam unë me përvojë shumëvjeçare. PSD-ja dhe unë e kemi prioritet mirëqenien e qytetarëve. Koalicioni AAK-PSD e ka programin më të mirë. Të dy partitë për çështje ekonomik, sociale, për arsimin dhe për shëndetësinë, kanë mirëkuptim 100 për qind. Nëse unë do ta marrë besimin e qytetarëve për t'u bërë deputete premtoj se do të jem besnike e realizimit të këtij programi.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh përvojën tuaj politike në rrethana të ndryshme, si e shihni ecurinë e procesit të dia-

logut me Serbinë pavarësisht se kush do ta udhëheqë qeverinë e re?

Jashari: Procesi i dialogut duhet të përfundojë sepse kjo është në interes të Kosovës. Po ashtu, është edhe në interes të Evropës që të ketë stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Mirëpo nuk mendoj se do të jetë i lehtë aspak përfundimi i këtij procesi, megjithatë nuk duhet bërë kompromise në dëm të vendit tonë. Kosova ka bërë kompromise të mëdha kur kemi aprovuar Pakon e Ahtisarit, kur kemi formuar komunat etnike, kur kemi lënë vendet e rezervuara në Kuvend si dhe kompromise të tjera. Dialogu duhet të vazhdojë, por nuk duhet lejuar krijimi i mekanizmave që e cenojnë funksionimin e shtetit.

Kosova duhet të jetë e plotë dhe të funksionojë si shtet 100 për qind.

"Epoka e re": Por lideri i koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, insiston që taksat nuk do të hiqet, ndërkohë që procesi i dialogut nuk pritet të rifillojë pa u larguar taksat.

Jashari: Edhe unë jam që taksat mos të hiqet. Ndërkombëtarët po kërkojnë heqjen e taksës, por kjo mund të bëhet edhe në mënyra të tjera. Dialogu duhet të fillojë dhe kur të arrihet një marrëveshje e cila parasheh njohjen e Kosovës nga Serbia, atëherë mund të hiqet taksat. Serbia nuk mund të vazhdojë më tutje që edhe mos ta njohë Kosovën, por në të njëjtën kohë tregun e saj ta ketë të lirë.

Pacolli në Gjilan premtion vende të reja të punës



GJILAN, 2 TETOR (ER) - Aleanca Kosova e re (AKR) të mërkurën ka vazhduar fushatën elektorale në Komunën e Gjilanit. Në këtë tubim elektorale kanë marrë pjesë Behgjet Pacolli dhe kryetari i Partisë së Drejtësisë (PD), Ferid Agani.

Pacolli ka thënë se Gjilanin e konsideron si shtëpi të vetën. Ai ka thënë se tash po ndodh fushatë e madhe e gënjeshtrove nga kundërshtarët e tij politikë. "Vetëm përmes punës arrihet te

suksesi dhe krijohen kushte më të mira për qytetarët. Kursi ynë asnjëherë nuk ka ndërruar. Kemi qenë liberalë dhe kemi rrugëtuar me ju si liberalë, për arsye se liberalizimi u takon njerëzve punëtorë. AKR-ja është partia e parë që u profilizua në Kosovë si liberale. Ne jemi anëtarë të liberalëve evropianë. Ne jemi në familjen e tyre, ne ia dimë vlerën punës dhe qytetarit. Si AKR kemi krijuar shumë ide të cilat kanë qenë të nevojshme që të zbatohen dhe disa prej tyre

presin kohën e duhur që të zbatohen. AKR-ja ka vullnet që t'i zbatojë projektet për qytetarët e Kosovës. Ju e dini që prej vitit 2007 kur kam ardhur këtu dhe deri sot kam krijuar rreth 5 000 vende të reja të punës në Kosovë", ka thënë Pacolli.

Lideri i AKR-së ka theksuar se ai do të krijojë sërish vende të reja të punës. "Kam dëgjuar shumë premtime dhe fjalë boshe të liderëve të tjerë. Dikush flet për korrupsionin, dikush flet për 100 për

qind, dikush premtion kodra dhe livadhe, por ne veprojmë. Ministrat e AKR-së në qeverinë që ishim kanë punuar me duar të pastra", është shprehur Pacolli. Ai ka shtuar se AKR-ja nuk ka mundur ta përfundojë planin për Gjilanin për shkak se vendi hyri në zgjedhje të reja.

Pacolli ka përmendur disa projekte për të cilat ministrat e AKR-së kanë realizuar në mandatin e fundit qeverisës. Ndërkaq në qytetin e Vushtrisë, Pacolli ka thënë se 6

tetori është një mundësi e mirë për ridrejtim të Kosovës. "Këtë po ma dëshmon Vushtrria dhe banorët e fshatit Kçiq me një pjesëmarrje masive dhe entuziazëm në rritje nga mbështetja qytetare për Aleancën Kosova e Re. Frymën e lirisë ekonomike, mundësive të barabarta, zhvillimit ekonomik, prosperitetit dhe hapjes së vendeve të reja të punës, jemi duke e përçuar në çdo komunë. 6 tetori do të jetë fitore e madhe", ka thënë Pacolli.

Vjosa Osmani në Podujevë: Na nevojitet përkrahje e fuqishme që ta bëjmë ndryshimin e madh

PODUJEVË, 2 TETOR (ER) - Para mijëra simpatizantëve të Komunës së Podujevës, kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, është zotuar të mërkurën se edhe tri ditë i ndajnë nga fitorja. "Ju e dini shumë mirë që kur e kam dhënë besën, kurrë nuk e kam shkelur atë. Kurrë koalicion me PDK-në! Kurrë koalicion me regjisorët e 'klanit pronto', të cilët me krim dhe korrupsion, me montazhe dhe falsifikime po synojnë ta manipulojnë vullnetin e qytetarëve", tha Vjosa Osmani.

Nënkryetarja e LDK-së ka thënë se 'klani pronto' me krim dhe korrupsion e ka shkatërruar shtetin dhe e ka vrarë shpresën e rinisë sonë. Ajo shtoi se janë të kota përpjekjet që me montazhe dhe falsifikime të

krijnë përçarje në LDK, sepse "ne jemi më të bashkuar se kurrë". "Të nderuar qytetarë të Podujevës dhe krejt Kosovës, duke i parë gjithë këta përkrahës këtu në Podujevë dhe në gjithë Kosovën, unë nuk kam më dyshim për përcaktimin tuaj pro LDK-së. Këtë herë na nevojitet përkrahje edhe më fuqishme që ta bëjmë ndryshimin e madh. Ju lus që pjesëmarrja në zgjedhje të jetë masive sikur në kohën e presidentit Rugova, për ta jetësuar vizionin e tij për Kosovën shtet demokratik të zhvilluar dhe në miqësi të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian", ka thënë Vjosa Osmani.

LDK-ja ka mbajtur fushatë elektorale në Prishtinë dhe Fushë-Kosovë.



Haradinaj në Drenas: Ruajeni votën



PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga koalicioni AAK-PSD, Ramush Haradinaj, u ka bërë thirrje të mërkurën qytetarëve të Drenasit që ta ruajnë votën në ditën e zgjedhjeve. Gjatë një tubimi elektorale ai ka thënë se çështja e stadiumit nacional është e kryer dhe, sipas tij, ai do të ndërtohet aty ku është premtuar. "Po ju them me i dalë në ballë, se këtu kah akshami 'shuhen' dritat kur votohet dhe nuk ka lidhje për kë votoni. Ju lutem, ruajeni votën tuaj!", ka thënë Haradinaj.

Ai ka treguar edhe për prioritetet e tjera të tij para qytetarëve të Drenasit. "Do të ndërtohet stadiumi kombëtar sepse është në territorin tuaj dhe është një vepër e madhe. Ky stadium do të ketë rëndësi të jashtëzakonshme. Kemi edhe sistemin e ujitjes dhe rruga do të zgjerohet. Pra, rruga

me katër korsi prej Komoranit e deri në Skenderaj do të kryhet. Në sektorin publik kemi bërë ligje dhe pagat tashmë janë rregulluar", ka thënë Haradinaj.

Kurse kandidati për deputet nga ky koalicion, Shyqiri Bytyqi, ka deklaruar se koalicioni i tyre do ta kthejë shpresën dhe të rinjtë e vendit do të kenë mundësi ta organizojnë jetën e tyre në Kosovë. "Këto zgjedhje ne duhet t'i fitojmë që ta realizojmë programin dhe ofertën tonë. Kjo fitore duhet të bëhet 100 për qind për shtet. Kosova sot ka shumë sfida, por me përkrahjen tuaj ne do t'ia dalim, sepse ne kemi guxim dhe kemi dije dhe dimë të përballojmë çfarëdo sfide", ka deklaruar Bytyqi.

Koalicioni AAK - PSD ka mbajtur fushatë elektorale edhe në Rahovec dhe Prizren.

Kurti premton një të punësuar për çdo familje që është në skemë sociale

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, ka deklaruar se me qeverisjen e tij do të thyhen krimi, papunësia dhe varfëria. Gjatë një tubimi elektorale në Kaçanik ai ka premtuar të mërkurën që nëpërmjet punësimit sezonal do të punësojnë nga një anëtar të çdo familje që janë në skemë sociale. "Erdhi dita që të kujdesemi për ata që kanë nevojë për kujdesin e shtetit. Në një vend me kaq shumë varfëri, zor se mund të ketë një mendim demokraci. Ne jemi për demokraci. Në Kaçanik sot janë mbi 800 familje me mbi 3 mijë anëtarë të varur nga ndihma sociale, që i ofron veçse 80 centë në ditë. Për vete i morën fabrikat, fitimin e prodhimit, e juve jua lanë skamjen e mjerimin. Por, skema jonë e punësimit sezonal

do të garantojë një të punësuar për çdo familje që është në skemë sociale", ka deklaruar Kurti.

Duke shpallur premtimet e lëvizjes për qytetarët e Kosovës, ai ka thënë se është koha e ligjeve dhe masave. "Më shumë çerdhe për fëmijët e pavarësi për prindërit, duke ndarë shtesat për fëmijët në llogari të nënave, gratë i ruajnë paratë më mirë. Pra, 240 euro në vit për fëmijët nën dy vjeç, e 120 euro për fëmijët deri në 16 vjeç, në xhirollogari të nënës. Të gjitha familjet që kanë të ardhura të ulëta do të rimbursohen deri në 150 euro, varësisht prej të ardhurave vjetore që marrin si familje dhe kjo për secilin fëmijë nga një shumë të tillë", është shprehur.

Kurse kandidatja e kësaj lëvizjeje për deputete në Kuvendin e Kosovës, Vlora Gjakova, ka



deklaruar se gratë dhe vajzat do ta nisnin emancipimin e tyre kur të dalin dhe ta votojnë Lëvizjen Vetëvendosje. "Nuk jepet tokë për viza, por tregohet aftësi për inte-

grim. Në Ballkanin Perëndimor ne jemi fuqia më e madhe me zbatimin e prioritetëve të qeverisë Kurti. Energjia, pastërtia e institucioneve dhe fuqizimi i

gruas nisin më 6 tetor", ka deklaruar Gjakova.

Lëvizja Vetëvendosje të mërkurën fushatën elektorale e ka mbajtur edhe në Shtime dhe Prizren.

Veseli: Kosovës i duhet një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të mërkurën ka mbajtur tubim elektorale në Gjakovë.

Para simpatizantëve të kësaj komune ai ka thënë se Kosovës i duhet një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja. "Gjakovë, a po fitojmë? Kosovës i duhet një qeveri e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës. Sa është udhëhequr qeveria nga ne, shumë probleme që sot rëndojnë mbi qytetarët nuk kanë ekzistuar. Kosova atëherë kishte përparim. Kosova kishte integritet dhe bashkëpunim, jo izolim, stagnim dhe konfrontim me partnerë. Sepse Partia Demokratike e Kosovës ka punë, jo fjalë", ka deklaruar Veseli. Sipas tij, PDK-ja po i mban të shëndosha raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)

dhe se nën drejtimin e saj vendi do të ecë përpara me zhvillim ekonomik dhe pa korrupsion. "Kosovës i duhet një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja, e cila, bashkë me Amerikën, e lufton korrupsionin, e zhvillon vendin dhe jo një qeveri që e izolon edhe më shumë vendin dhe e thellon korrupsionin. Gjakovë, jepi fuqi Partisë Demokratike të Kosovës! Votoje numrin 112 për një të ardhme më të mirë", ka theksuar Veseli.

Më tutje, ai ka kërkuar mbështetjen e qytetarëve në mënyrë që pas 6 tetorit Kosova të jetë më e fortë përballë Serbisë. "Sa më e fortë është Kosova, më e dobët është Serbia me influencën e saj në Republikën e Kosovës", është shprehur ai.

Kurse në Rahovec Veseli ka thënë se pas zgjedhjeve të 6 tetorit më së shumti do të fitojë



Kosova. Ai u ka bërë thirrje kundërshtarëve politikë që mos të adresojnë akuza, por të ofrojnë programe konkrete të cilët do t'u shërbejnë qytetarëve. "Ata duhet të orientohen më shumë në projekte, çka do të bëjnë për Rahovecin, për të rinjtë, për luftën kundër korrupsionit, për fermerët. Pas 6 tetorit do të fitojë më së shumti Kosova, e Kosova fiton më shumë në adresën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës", ka thënë Veseli.

PDK-ja e ka vazhduar fushatën të mërkurën edhe në Malishevë dhe Therandë.

Limaj: Qytetarët e Kosovës po duan bashkim për shtetin

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga koalicioni Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka mbajtur tubim elektorale me strukturat dhe rininë e Nismës Socialdemokrate në Prishtinë. Me këtë rast, ai ka thënë se gjatë këtyre ditëve të fushatës zgjedhore, nga ajo që ka parë anembanë Kosovës, është fakti se qytetarët po e duan bashkimin për shtetin. "Kjo që po shohim sonte në Prishtinë dëshmon se jemi nisur fuqishëm në bashkimin e qytetit, jemi nisur fuqishëm në fitoret e mëdha dhe të përbashkëta si Nismë, si koalicion dhe si Kosovë. Këto ditë kemi vizituar gjithë Kosovën, jemi takuar me të gjitha moshat dhe shtresat e shoqërisë së Kosovës, kemi shpalosur programin tonë dhe kemi biseduar me qytetarë. Nga ajo që kemi parë, qytetarët duan bashkim për shtetin", ka deklaruar ai. Limaj ka thënë se ka ardhur koha

që qytetarët ta refuzojnë gjuhën e mashtrimeve dhe të helmimeve. "Qytetarët janë lodhur nga fjalët që nuk kanë rezultat, janë lodhur nga gjuha helmuese dhe gjuha e mashtrimeve të cilat, fatkeqsisht, jo rrallëherë janë shpërblyer. Projekti ynë bashkë për shtetin po mirëpritet në gjithë Kosovën sepse ka ardhur koha që të refuzohen mashtruesit", ka theksuar Limaj.

Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që më 6 tetor të votojnë për koalicionin Nisma-AKR-PD sepse, sipas Limajt, është shumë e rëndësishme që në këto zgjedhje të fitojë shteti i Kosovës dhe jo individit. "Qytetarët anekënd vendit po mbështesin projektin tonë Bashkë për Shtetin sepse është projekt që afron dhe bashkon njerëz të cilat duan të kontribuojnë për të mirën e vendit", është shprehur Limaj.

Para strukturave të partisë në Prishtinë ai ka folur për proceset



nëpër të cilat ka kaluar vendi, duke thënë se ai dhe bashkëpunëtorët e tij nuk kanë hequr dorë kurrë nga Kosova

pavarësisht prej sfidave me të cilat janë përballur. "Mos hiqni dorë nga Kosova! Pavarësisht prej sakrificave, ky vend do të

bëhet ashtu siç kanë dashur ata që kanë dhënë jetën dhe ashtu siç ëndërroni ju", ka theksuar Limaj.

Fillon fushata sensibilizuese 'Ma thuaj me kohë'

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 TETOR - Instituti i Mjekësisë Ligjore, në partneritet me Policinë e Kosovës dhe mbështetur financiarisht nga EULEX-i, kanë filluar një fushatë sensibilizuese të quajtur "Ma thuaj me kohë". Kjo fushatë ka filluar me diskutim në mes të palëve përkatëse rreth rëndësisë së ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale. Meqë statistikën e Institutit të Mjekësisë Ligjore tregojnë se shumica e viktimave të dhunës seksuale janë të moshës 11 deri 16-vjeçare, kjo fushatë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes në mesin e fëmijëve të shkollave rreth rëndësisë së ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale si dhe për të dhënë informata rreth

mënyrave të ruajtjes së provave të tilla që do të shërbejnë për sjelljen e kryerësve të veprave para drejtësisë. "Ky është kontributi ynë për t'i ndihmuar viktimat që ta arrijnë drejtësinë dhe ta thyejmë heshtjen që i rrethon ata që kanë diçka për të thënë dhe ata që duhet të dëgjojnë", ka thënë dr. Bergita Curri, specialiste e mjekësisë ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Kurse Arsim Gërxhaliu, drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ka thënë se ky institut mbetet i përkushtuar që të ofrojë shërbime sa më cilësore për viktimat e dhunës seksuale dhe ka shtuar: "Kjo fushatë sensibilizuese është një përpjekje, përtej detyrës zyrtare, për t'i ndihmuar ata/ato. Po ashtu, përmes këtij projekti duam ta nxisim diskutimin ndërinstitutional me qëllim të përmirësimit

it të trajtimit të këtyre rasteve në të gjitha hallkat", ka deklaruar ai. Fushata "Ma thuaj me kohë" parasheh organizimin e një sërë ligjëratash edukative për 32 shkolla fillore dhe të mesme nëpër Kosovë. Ligjëratat tanimë kanë filluar në Prishtinë dhe Fushë-Kosovë dhe po mbahen nga specialistë të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe nga përfaqësues të Policisë së Kosovës. Ligjëruesit do të ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes së nxënësve të shkollave në lidhje me situatat e mundshme që i ekspozojnë kategoritë e ndjeshme në rrezikun e të qenit viktimë e dhunës seksuale dhe në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale. Fushata "Ma thuaj me kohë" do të zgjasë deri në mes të vitit 2020.



Ekspertë nga Gjeneva ligjërojnë për bashkëpunimin ndërprofesional për sigurinë e pacientëve



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Një ekip i ekspertëve nga Qendra Klinike Universitare e Gjenevës (HUG) po mban trajnime dhe ligjëratë për mjekë dhe infermierë të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në kuadër të konferencës "Bashkëpunimi ndërprofesional për të përmirësuar sigurinë e pacientëve". Gjatë shkëmbimit të përvojave me kolegë nga Kosova, ky ekip nga Gjeneva theksoi rolin që ka kujdesi për pacientët, duke cekur edhe pengesat eventuale në këtë

praktikë bashkëpunuese që mund të shkaktojnë vonesa në mjekimin dhe kurimin e pacientëve dhe që mund ta rrezikojnë sigurinë e tij. Qëllimi i kësaj konference është për ta përmirësuar sigurinë e pacientëve përmes praktikës bashkëpunuese midis mjekëve dhe infermierëve. Po në këtë konferencë u tha se përmirësimi i sigurisë së pacientit është një nxitës i fortë për ndryshim, veçanërisht për të parandaluar ose shmangur ngjarjet anësore. Gjatë konferencës do të flitet edhe për komunikimin i cili përf-

shinë në mbi dy të tretat e ngjarjeve anësore të parandalueshme në kujdesin ndaj pacientit. Në grupe më të vogla kjo seancë ndërvepruese do të përqendrohet jo vetëm në përmbajtje, por edhe në strukturën dhe qëllimin e komunikimit. Gjithashtu, është diskutuar për aftësitë e udhëheqjes për të ndihmuar në menaxhimin e ekipeve dhe për ta koordinuar kujdesin e pacientëve. Rëndësi e veçantë do t'u kushtohet edhe protokolleve që udhëzojnë kujdesin e pacientit duke siguruar një proces të strukturuar.

Imunoterapia kundër kancerit do të fillojë të aplikohet edhe në Kosovë

PRISHTINË, 2 TETOR - Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019 rreth 1 300 persona janë prekur nga kanceri, thonë në Institutin Onkologjik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Sipas profesionistëve shëndetësorë të këtij Instituti, numri i të prekurve me kancer këtë vit është rreth katër për qind më i lartë krahasuar me vitet para-prake. Në përpjekje të shtimit të përkujdesjes shëndetësore për pacientët e prekur me kancer edhe në Kosovë, nga viti i ardhshëm paralajmërohet që, krahas terapive standarde, do të aplikohet edhe imunoterapia. Imunoterapia është një lloj i trajtimit për shërimin e kancerit, përmes së cilës rritet aftësia natyrore e trupit për t'u mbrojtur nga qelizat e kancerit. Në

vende të ndryshme botërore kjo lloj terapie ka filluar të aplikohet, ndonëse kostoja e ilaçeve thuhet të jetë shumë e shtrenjtë. Ilir Kurtishi, drejtor i Institutit Onkologjik, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", tha se në Kosovë nga viti i ardhshëm në listën esenciale të barnave do të jenë edhe disa lloje të barnave që i takojnë grupit të imunoterapisë. "Imunoterapia është shtylla e pestë e mjekimit onkologjik, pas formave standarde të mjekimit bashkë me target-terapinë. Imunoterapia ka dy vjet që ka filluar të përdoret shumë, sidomos te kanceret e lëkurës, duke bërë revolucion dhe duke e rritur jetëgjatësinë. Andaj, ne do të kemi fatin që nga viti i ardhshëm t'i kemi dy lloje të ilaçeve të imunoterapisë si pjesë



e listës esenciale. Kjo përdoret te format metastatike të melanomave", ka thënë Kurtishi. Ai ka shtuar se do të ishte mirë që përdorimi i imunoterapisë të

shtrihet edhe te tumoret e mushkërive, te të cilat, siç thotë ai, ka problem për menaxhimin e formave metastatike. Sipas profesionistëve shëndetësorë, ilaçet për trajtimin e sëmundjes

së kancerit janë të shtrenjta dhe shkaktojnë disa efekte anësore. Andaj si alternativë po mendohet të aplikohet imunoterapia për pacientët me sëmundje malinje.

ShBA-ja do të vendosë tarifa në mallra të BE-së në vlerë të 7.6 miliardë dollarëve

WASHINGTON, 2 TETOR - Shtetet e Bashkuara do të vendosin tarifa në mallra të Bashkimit Evropian në vlerë të 7.6 miliardë dollarëve. Ky është kapitulli i fundit në betejën 15-vjeçare në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për shkak të subvencioneve të dhëna për kompaninë ajrore Airbus dhe kompaninë rivale amerikan, "Boeing". Kjo nënkupton vënien

të tarifave në mallra nga aeroplanët deri te butakët.

Komisioni Evropian ka thënë se tarifatat nuk do të kenë efekt të kundërt.

Ky vendim është marrë nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), e cila ka mbikëqyrur mosmarrëveshjet tregtare. Ajo ka zvogëluar shkallën e tarifave nga 11 miliardë dollarë sa ka shpresuar se do t'i vendosë

ShBA-ja.

Komisioni i kësaj organizate ka thënë se të dyja palët duhet të tentojnë të arrijnë një marrëveshje. "Mirëpo nëse Shtetet e Bashkuara vendosin të aplikojnë kundërmasa të autorizuara nga OBT-ja, kjo do ta shtyjë BE-në në një situatë ku ne nuk do të kemi mundësi tjetër përveçse të veprojmë njëjtë", ka thënë Komisioni Evropian.



'Ziraat Bank' hapi degën e katërt në Ferizaj

Prishtinë, 2 tetor (ER) - "Ziraat Bank", e cila menaxhon një ndër portofolit më të mëdha të Turqisë dhe është një nga bankat më të mëdha të Turqisë me 12 për qind pjesëmarrje në pasuritë totale të shtetit, që udhëheq sektorin me një grup të gjerë të produkteve dhe shërbimeve, tashmë ka hapur degën e saj të katërt në Ferizaj pas degës së Prishtinës, të Prizrenit dhe të Pejës në të cilat funksionon që nga viti 2015. "Shërbimet e vazhdueshme dhe superiore për klientët e saj të ndara në segmentet bankare sipërmarrëse, të korporatave, komerciale dhe individuale, kanë bërë që kjo bankë degën e 102-të ta hapë në Ferizaj si kërkesë e vazhdueshme dhe në rritje e klientëve të saj. Përmes hapjes së kësaj dege 'Ziraat Bank' është një hap më afër arrijtes së objektivave për t'u bërë një ndërmjetëse në tregtinë e jashtme midis dy

vendeve dhe për përmbushjen e të gjitha llojeve të nevojave financiare të klientëve të saj, veçanërisht korporatave, përmes rrjetit të degëve të saj që po përhapen në tërë Kosovën", është thënë në njoftimin e "Ziraat Bank".

Sipas këtij njoftimi, përveç Kosovës, Ziraat Finance Group ka degë në Mbretërinë e Bashkuar, Bullgari, Greqi, TRNC, Irak, Bahrein dhe Arabinë Saudite dhe banka ndihmëse në Gjermani, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Rusi, Gjeorgji, Azerbajxhan, Kazakistan, Uzbekistan dhe Turkmenistan. "Prania e saj me degë dhe filiale të huaj në 102 pika në të gjithë botën, si një ofrues global i shërbimeve financiare, gjithashtu kontribuon në marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Turqisë dhe vendeve ku operon", thuhet në njoftimin e "Ziraat Bank".



Ramiz Kelmendi viziton 'Frutex'-in

PRISHTINË, 2 TETOR - Pronari i "Elkos Group", Ramiz Kelmendi, ka vizituar të mërkurën drejtorin e kompanisë "Frutex", Shaqir Palushi, me të cilin janë marrë

vesh për bashkëpunimin e mëtutjeshme mes dy kompanive. Palushi e cilësoi kompaninë "Elkos Group" si një ndër partnerët më të rëndësishëm të "Frutex"-it.

Ekonomia në Shqipëri u rrit 2.31 për qind, ndikim negativ energjia dhe bastet

TIRANË, 2 TETOR (ER) - Ekonomia e Shqipërisë ka shënuar sërish rënie në tremujorin e dytë, teksa prodhimi kombëtar u rrit vetëm 2.31 për qind. Instat ka njoftuar se rritja e dobët është rezultat i tkurrjes së dy sektorëve. Sipas Instat, përveç energjisë dhe basteve, një tjetër sektor me rënie ka qenë edhe ai i ndërtimit. Ndërsa të gjitha degët e tjera të ekonomisë kanë shënuar rritje të udhëhequra nga turizmi dhe bujqësia. "Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët: tregti, transport, akomodim dhe shërbim ushqimor me +0,71 pikë përqindje, kurse aktiviteti i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit me +0,41 pikë përqindje", thuhet në njoftimin e Instatit.


Efektet e rënies së prodhimit

energjetik dhe mbylljes së basteve për ngadalësimin e ekonomisë pritet të jenë të përkohshme. Ekonomia po përballlet me një risk të ri, rënien e investimeve private. Katër vjetët e fundit investimet

në ekonomi kanë përfituar nga ndërtimi i gazsjellësit tap dhe kaskada e Devollit. Por tashmë këto projekte po shkojnë drejt përfundimit, duke krijuar një hendek jo të vogël në kërkesën agregate.



Përjetimet e të bërit fushatë me pullë të kuqe për zgjedhje, pa zgjidhje!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Nuk bëhesh dhëndër me alete të Hasanit: Fushata para zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 ka filluar të bëhet e bezdisshme, e lodhshme dhe e pabesueshme sikur edhe fushatat e tjera para kësaj. Realisht, kjo fushatë i ka disa dallime apo një kualitet që u ka munguar fushatave të tjera; pastrimi i listave nga të akuzuar për korrupsion dhe krim të organizuar, futja në lista e më shumë të rinjve, mobilizimi më i madh në terren, mobilizimi më i madh i diasporës dhe sqarimi si duhet të votohet, premtimet e cunguara për disa procese që nuk varen nga ne sikur që është liberalizimi i vizave, anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë etj. Shqetësim ende mbetet përfaqësimi joproporcional i femrave në lista krahasuar me përqindjen e popullsisë së Kosovës. Kjo fushatë karakterizohet edhe me dhunën dhe terrorin që ushtrohet nga Beogradi ndaj liderëve dhe votuesve serbë të Kosovës e që nuk janë në të njëjtat frekuenca politike dhe shoviniste me Listën Serbe. Gjithashtu, kjo fushatë karakterizohet me mungesë të ndjesisë elementare politike të faktorit politik kosovar që, jo që nuk solidarizohet me serbët lokalë të integruar në Kosovë dhe me përndjekjen kriminale që ua bënë Beogradi qoftë edhe përmes një deklarimi formal publik, por as edhe të faktorit vendimmarrës ndërkombëtar që ka sjellje tipike oportuniste dhe i bënë llogaritë se çka fiton apo çka humbet nëse del kundër Listës Serbe. Po të kishim votues të përgjegjshëm, më parë do të votonim për Nenad Rashiçin, Slobodan Petroviçin sesa për Begjën apo një duzinë hajdutësh që nuk kanë lënë të zezë pa bërë dhe tash po shesin moral. Nenad Rashiç, në një shqipe shumë më të artikuluar se Begja dhe disa politikanë të tjerë kosovarë e kërkoi votën, siç tha ai, për ta bërë një rrugë të përbashkët për të mirën e Kosovës dhe, që ishte një kërkesë e pranueshme për, së paku 99 për qind të kosovarëve, përjashtuar këtu disa politikanë, për ta hequr qafe një monstrum politik - Listën Serbe. Natyrisht se me këtë nuk pajtohen disa politikanë kosovarë sepse e adhurojnë Listën Serbe

si vjegëz për të ardhur në pushtet.

Karakteristikë tjetër e kësaj fushate është fakti se po kërkohet përkrashje nga disa politikanë ndërkombëtarë, që janë, ose të deklasuar, ose afër deklasimit apo kanë ndikim aq sa kam unë në vendimet që i merr Këshilli i Pleqve i fisit Zulu në Afrikë. Është bërë si rregull që para zgjedhjeve në Kosovë "zhvendosen" përfaqësues të partive evropiane, pjesë e së cilës janë edhe disa parti tona. Edhe tash nuk mungoi përkrashja për LDK-në nga partitë popullore evropiane sikur që edhe një deputet i majtë gjerman përkrashje Albin Kurtin dhe LV-në. Doris Pak e përkrashje Vjosën jo si lidere, por si femër. Ka hyrë përjetësisht në të gjitha arkivat botërore përkrashja publike që i jepej nga liberalët evropianë, politikanit të shquar trim dhe të mençur e, mbi të gjitha, të pathyeshëm dhe parimor siç ishte Gjergj Dedaj. Mos të flasë për përkrashjet brendashqiptare. Dikush nga politikanët shqiptarë të Maqedonisë së Veriut e përkrashin Kadri Veselin, Ziadin Sela dhe Blerim Reka e përkrashin Albinin dhe LV-në. Kadri Veseli, përkatësisht PDK-ja, e lansoi një bombë të pashpërthyer të përkrashjes, të emëruar si z. Witaker, ish-prokuror i administratës së Trampit. Madje me te paska drekuar edhe një kingburger për të cilin mendoj se e ka një çmim astronomik. Bifteku i Nexhatit që ia serviloi Thaçit në Nju Jork del të jetë jashtëzakonisht i lirë krahasuar me kingburgerin e Buçajve. Unë nuk kam pretendime për pushtet por, midis alternativës që të dal në një foto me Trampin dhe mbetjes së përjetshme në opozitë, nuk e kam asnjë dilemë, çdo opozitë është më e mirë se fotoja me Trampin. Edhe Begja e ka kuptuar këtë, prandaj nuk po e përdor fare fotografinë kur u përshëndet me Trampin në kohën kur Trampi doli nga vendi ku mbreti shkon me këmbë dhe kur qartazi shihej se Trampi, me një dorë e mbante dorën e Gjet Pacollit, kurse me tjetrën i mbërthente pantallonat ku i ravijëzoheshin mbetjet e diçkaje që dikur ia identifikonte gjininë. Mendoj se, edhe sa iu përket votave, Kadri Veseli do të fitonte më shumë vota po ta bënte një foto dyshe me Samiun (Lushtakun), i cili, kur e takova për herë të fundit, me atë mjekërzen si Lao Ce, dukej bukur simpatik. Samiu është bukurosh krahasuar me Trampin. Dukej se kishte bërë një trajtim të fytyrës te Shaipi. Mos të flasë se sa vota do të fitonte po të fotografohej me Leonorën që e ka një bukuri

natyrore dhe përrallore! Nuk e di që ka rast në botë kur një politikan të ketë fituar vota, i shoqëruar me gruan?! Në raste të ngjashme si puna e përkrashjes ndërkombëtare në popull është një thënie: "Nuk hyhet dhëndër me rekuizite të Hasanit...!"

1. Lidhja Demokratike e Kosovës: Po e bën një fushatë pa përmbajtje dhe tipike si puna e dhëndrit dhe Hasanit. Po e përdorë një fjalor që është në s'përputhje me "filozofinë" e kësaj partie që kryesisht po thirret në të kaluarën. Po kërkon vota nga varri dhe vrasjet e pasluftës për sqarimin e të cilave, ndonëse kishte shumë mundësi, nuk bëri asgjë. Tash e ka angazhuar një këngëtare që po e këndon një këngë anakronike: "Ushtrinë time do ta bëj me Ibrahim Rugovën" disa vjet pasi Rugova ndërroi jetë. Edhe sa ishte gjallë Rugova ishte kjo këngë dhe absurditeti i saj ishte dhe është se Rugova, si njeri i paqes dhe mosdhunës, kurrë nuk do të bënte ushtri. Nuk kishte këllqe për ushtri e lëre më të marrë përgjegjësi. Rugova ishte intelektual, i ndjeshëm dhe i lëndueshëm. Intelektualët, përjashtuar Hasan Prishtinën, nuk bëjnë ushtri, nuk e duan luftën sepse e preferojnë mrizin. Jo vetëm në Kosovë, por në çdo vend të botës. Isa Mustafa ka vepruar si filigranist dhe më dhelprë se të gjitha dhelprat, madje edhe se dhelpra polare! E shpëtoi përkohësisht LDK-në nga një përçarje e thellë duke i bërë bashkë ata që i kishin raportet si ujku me delet. E rehatoi Vjosën përkohësisht, pretendentin permanent për kryetar të LDK-së dhe kryeministër e bëri koordinator dhe përgjegjës për fushatë zgjedhore, kurse të moçmit e LDK-së i bëri si kori i pleqve të Mapet Shou, të cilët tremben dhe qeshin me pordhët që i bëjnë vetë. Me një të rame, dy të vrame! Nëse Vjosa dhe LDK-ja i fitojnë zgjedhjet atëherë Isaja do të thotë se bëri zgjedhje të qëlluar me Vjosën dhe Lutën kurse, nëse del pas PDK-së e që ka mundësi reale të ndodhë kjo, atëherë i largon edhe Vjosën sikur edhe Lutën, me pretekstin se iu dha mundësinë, por se nuk e shfrytëzuan si duhet. Ndonëse Isa Mustafa po vepron nga hija, nuk e besoj se është zhveshur nga ambiciet politike. Lista e LDK-së nuk ka ndryshime të mëdha, ka ndryshime kryesisht kozmetike. Slogani i LDK-së, BESO me një pullë të kuqe është misterioz, slogan i masonëve, mistik deri në fund sepse askush nuk e ka dhënë kuptimin e saj. Në aspektin gjuhësor është i

paqëndrueshëm, kurse nëse e konsultoni fjalorin seksologjik është tundues dhe shumë erotik. Pulla e kuqe në shumë raste është shenjë e rrezikut, paralajmëron rrezik. Nëse ju ndizet në makinë, puna nuk është mirë. Nëse shkoni në Amsterdam, pulla e kuqe është biletë hyrëse për aktivitete seksuale. Nëse e ndizni televizorin, pulla e kuqe jua hap mundësinë e kanaleve me përmbajtje erotike. Pulla e kuqe identifikohet me shtëpitë publike, me kurvëri dhe prostitucion! Nuk e besoj se kjo ndërlihet me LDK-në, ndonëse aty janë disa prostituta politike (100 për qind) të gjinisë mashkullore që, thuaja, që nga themelimi mbijetojnë duke ofruar shërbime ekskluzivisht të prostitucionit politik. LDK-ja nuk do ta njohë veten pas zgjedhjeve, e kam fjalën këta që po flasin fjalë të mëdha kurse, në çastin kur duhet të marrin vendime, i kanë koç... e zogut dy javësh!

2. Partia Demokratike e Kosovës: E ka fushatën shumë të mirë dhe askush nuk e ka futur thikën aq thellë në trupin e partisë sa e ka bërë PDK-ja. Është e vërtetë se ka nepotizëm në listat e PDK-së, por se është nepotizëm kalimtar, ku deri në legjislaturën e fundit zëvendësuesit kanë qenë kopje e zbehtë e origjinalit. Nuk po më duket e qëlluar që Kadri Veseli ka dalë në foto me Trampin dhe flintonin! Më mirë do të ishte të fotografuhej me Sami Lushtakun dhe Monika Levinskin! PDK-ja e ka një listë të mirë, madje shumë të mirë për zgjedhjet e 6 tetorit, nga ata që kanë kontribuar për liri dhe pavarësi, në krye me Hashim Thaçin dhe nga ata që i kanë të gjitha mundësitë të kontribojnë për ardhmëri të ndritshme, në krye me Hashim Thaçin. Në grupin e parë janë Kadriu, Ilmiu, Hajdari, Blerimi, Valoni dhe ca komandantë të tjerë të përkrashur forcërisht nga Ramiz Lladrovci, kurse në grupin e dytë janë Shqiptari, Merita, Eliza, Valdeti, Memli, Hajredin Pasha, Abelardi etj. Kadri Veseli po demonstroi kondicion të një terminatori dhe gjithëprani. Ka tolerancë brenda partisë sikur edhe për kundërshtarët politikë. Nuk po më pëlqen që në disa raste, fjalori i tij është copy paste i LDK-së, ka karakter denoncues përballë interesave ndërkombëtare. Besoj se ka vullnet ta luftojë korrupsionin, por se koha e deklarimit është e papërshtatshme. Ka bërë përmirësime në komunikim me opinionin e që më parë e kishte "thembër të Akilit". PDK-ja mund të dalë partia fituese, në rastin më të keq del e dyta. Aktualisht, PDK-ja është sikur çifutët në prag dhe

gjatë Luftës së Dytë Botërore; të përndjekur nga të gjitha subjektet politike. Është shndërruar në viktimë! Pikërisht ky status i imponuar nga subjektet leshko që kanë vija të kuqe dhe një të kaluar të zezë sikur edhe proceset nëpër të cilat do të kalojë Kosova, nuk e lënë PDK-në jashtë institucioneve. PDK-ja, po të kishte një vizion politik, vullnetarisht, pavarësisht prej rezultateve në zgjedhje, do të kalonte në opozitë. Në këtë mënyrë do t'ua linte në duar "këmbët e Hashimit" këtyre që po e gjakojnë aq shumë pushtetin. Por, PDK-ja nuk e do opozitën ku do të jetë edhe vetë sikur që as ndërkombëtarët, nuk e besoj se do ta lënë në opozitë. PDK-ja tradicionalisht ka afërsisht 220 000 vota. Kësaj radhe janë tri elemente që mund ta nxjerrin këtë parti në vend të parë ose të dytë; a) mobilizimi i madh në terren, b) sjellja irracionale dhe përjashtuese e partive të tjera politike dhe, c) proceset përkatësisht bisedimet me Serbinë.

3. Lëvizja Vetëvendosje: Është mobilizuar shumë sidomos në diasporë. Me çdo kusht dëshiron të jetë partia e parë dhe ta bëjë Albinin kryeministër. Albin Kurti ka një përparësi të madhe në fushën e retorikës përballë kundërshtarëve garues. Mendoj se është patriot, i mençur dhe i pakorruptuar, parakushte këto për një qeverisje të mirë dhe ndryshim të qeverisjes. Proceset politike nuk janë në favor, as të LV-së, në veçanti jo të Albinit. Albin Kurti po sillet si mohikani i fundit i ndershmërisë duke i akuzuar të tjerët për korrupsion dhe pandershmëri. Në këtë fushatë Albin Kurti është vetë LV-ja; të gjitha debatet po i bënë vetë, pa bërë përzgjedhje të kundërshtarëve. Nëse LV-ja i fiton zgjedhjet atëherë kjo do të jetë fitore e Albin Kurtit, fitore personale. Nëse nuk del e para atëherë do të jetë humbje e LV-së dhe jo e Albinit. Sipas vlerësimit tim, Albin Kurtin nuk e lënë në këtë kohë as t'i udhëheq bisedimet e as ta udhëheqë qeverinë, kurse Albini, për sa e njoh, nuk do të pranojë të bëhet zëdhënës i Vjosa Osmanit apo një lideri tjetër partiak. E kam një mik shumë të mirë dhe shumë të mençur, Agon Shipninë nga Prizreni, prej shqiptarëve të lashtë që e ndanë këtë mendim me mua, madje më tha se, hipotetikusht, nëse bashkësia ndërkombëtare e pranon Albinin si lider, do ta pranojë me kusht që ai të bëhet Aleksandar Vuçiqi i Kosovës, të bëhet skajshëm për të besuar! LV-ja dhe Albini kanë ndryshuar shumë si në sjellje ashtu edhe në veshje. Më

herët, po të të shihnin me kollare, do t'ju përndiqnin sikur që i ndiqte Makarti komunistët në ShBA, kurse tani, edhe kur flenë, flenë me kollare dhe ekziston rreziku të ngulftaten gjatë fjetjes. LV-ja i ka të gjitha gjasat të mbetet në opozitë.

4. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe PSD: Nuk do të ndahen keq me vota duke falënderuar Ramush Haradinajn. Ramushi, me taksën 100 për qind, 100 për qind e pengoi ndarjen e Kosovës dhe këtë e përforcoi më shumë me dorëheqjen nga posti i kryeministrit. Nuk i besoj aspak PSD-së, ndonëse kjo ka shumë merita për marginalizimin e Listës Serbe. Ramush Haradinaj, në asnjë rrethanë, së paku kështu besoj, nuk do ta tradhtojë interesin kombëtar dhe shtetëror. Pavarësisht prej çmimit që duhet të paguajë. Nëse Ramushi nuk ka shkollim përkatës politik atëherë këtë e kompenso me një inteligjencë të jashtëzakonshme që e ka të lindur dhe trashëgimi. Kaq.

5. Nisma Socialdemokrate dhe AKR, analfabete dhe burokrate: Nisma do të ndahej më mirë pa Pacollin se me Pacollin. Nëse e kalon prapun, për mua do të ishte gjysmëbefasie. Në këto rrethana. Mirëpo ekziston edhe një element befasia për ata që nuk janë të dashuruar në Limën, Pacollin dhe Gashin; duke mos e kaluar prapun, lirohen nga këta tre!

Pse nuk pres asgjë nga këto zgjedhje: Pas dorëheqjes së kryeministrit dhe rënies së qeverisë si dhe shpërbërjes së Kuvendit ishin dy reagime që më sigurojnë se këto zgjedhje nuk bëhen për përmirësimin e jetës së qytetarit, por për vazhdim të bisedimeve dhe arritjes së marrëveshjes me Serbinë: 1) Ambasadori Kosnet deklaroi se ShBA-ja pret një qeveri stabile që do t'i vazhdojë bisedimet me Serbinë, që do ta heqë taksën 100 për qind dhe që do të ketë ide kreative për këto bisedime dhe 2) Vendet e Kuintit deklaruan se qeveria e re e Kosovës duhet ta heqë taksën, t'i vazhdojë bisedimet me Serbinë, të arrijë një marrëveshje me këtë shtet sikur që duhet të demonstrojë fleksibilitet në këto bisedime.

Askund nuk përmendet si prioritet luftimi i korrupsionit dhe krimi të organizuar, por se prioritet mbi prioritetet është vazhdimi i dialogut, heqja e taksës, arritja e marrëveshjes dhe demonstrimi i fleksibilitetit. Për këto projekte nuk ka kombinim më të mirë se LDK-ja dhe PDK-ja + partitë e vogla dhe minoritetet. Në këto rrethana nuk ka vend për LV.

Lehtë mund të ndodhë që duke bërë përpjekje të tregohem si fort i mençur, e huqi krejt parashikimin tim. Nëse e huqi, do të jem i gëzuar; nëse ia qëlloi, do të ndihem i trishtuar!

Nis rekonstruktimi i kompleksit "Qafa" në Prishtinë

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kanë nisur punimet për rekonstruktimin e hapësirës të kompleksit "Qafa" në kryeqytet, vlera e të cilit është 1 milion euro. Nga afër punimet i ka inspektuar kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, i cili ka thënë se ka nisur një ndër projektet më të mëdha në këtë komunë. Ai ka thënë se ky projekt do t'ia shtojë gjallërinë kryeqytetit. Sipas tij, ky projekt, i cili

pritet të përfundojë për 12 muaj, parasheh rehabilitim të trotuareve, shtim të gjelbërimit, kënd të lojërave për fëmijë, një fushë sportive për basketboll. Projektuesja e projektit për rehabilitim të kompleksit "Qafa", Yllka Kosumi, është shprehur e lumtur që projekti i saj ka nisur të jetësohet derisa ka kërkuar që punimet të zhvillohen në kohën e paraparë dhe ashtu siç duhet.



Gjashtë familje skamnore në Skenderaj do të bëhen me shtëpi të reja

SKENDERAJ, 2 TETOR (ER) - Familja e Rasim Gashit nga Rezalla, Hasan Hajrizi nga Abria, Bekim Ferizi nga Mikushnica, Bekim Selimi nga Kopiliqi i Poshtëm, Ajet Xhemajli nga Kopiliqi i Epërm dhe Xhemë Xhokaj nga Skenderaj kanë marrë lajmin e mirë se do t'u ndërtohen shtëpitë e reja falë bashkëpunimit në mes të Komunës së Skenderajt dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit".

Komuna e Skenderajt dhe kjo shoqatë, në bashkëfinancim të projektit të përbashkët, do t'u



bëjnë zgjidhje për banim familjeve të cilat jetojnë në kushte shumë të vështira. Për çdo shtëpi kjo komunë do të participojë shumën prej 5 000 eurosh, ndërsa pjesën tjetër do ta mbulojë shoqata "Jetimat e Ballkanit".

Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, në emër të familjeve përfituese dhe të qytetarëve dhe komunës ka falënderuar hoxhën Halil Kastrati për këtë bashkëpunim të jashtëzakonshëm nëpërmjet të cilit po u kthehet buzëqeshja familjeve nevojtare.

Përfundon asfaltimi i rrugëve në disa fshatra të Drenasit



Drenas, 2 tetor (ER) - Komuna e Drenasit ka bërë me dije se është duke vazhduar t'i realizojë projektet e planifikuara dhe që janë në shërbim të mirë të qytetarëve të saj, duke treguar kështu përkushtimin dhe seriozitetin për përmbushjen e të gjitha projekteve të premtuara. "Në kuadër të mbi 80 projekteve të planifikuara, edhe sot ka përfunduar asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat Llapushnik, Poterk dhe Vukovc, përkatësisht lagjja Çupi, Thaqi, Sopi e Gashi. Vlera e investimit në këto rrugë kap shifrën prej 130 mijë eurosh, ndërsa gjatësia e rrugëve të shtruara me asfalt është mbi 2.3 kilometra", ka njoftuar Komuna

e Drenasit. Sipas këtij njoftimi, Drejtoria për Infrastrukturë Lokale ka arritur që të përfundojë me sukses projektet e investimeve kapitale për këtë vit, ku tanimë është në fazën përfundimtare të realizimit të tyre. "Kështu kanë përfunduar asfaltimet e rrugëve në lagjet e fshatrave: Korroticë e Epërme, Zabel i Ulët, Poklek i Ri dhe i Vjetër, Sankoc, Fushticë e Ulët dhe e Epërme. Gjatësia e këtyre rrugëve në lagjet e fshatrave të lartpërmendura është mbi dy kilometra. Në disa lagje të këtyre fshatrave është bërë edhe rregullimi i rrugëve me zhavorr", është thënë në njoftimin e kësaj komune.

Fillon ndërtimi i urës në rrugën e "UÇK-së" në fshatin Marali të Malishevës

MALISHEVË, 2 TETOR (ER) - Këto ditë ka filluar ndërtimi i urës në rrugën e "UÇK-së" (rruga Dragobil-Dobërdelan), në fshatin Marali, pasi rruga ishte dëmtuar gjatë vërshimeve të këtij viti. Ndërtimin e urës në Marali të mërkurën e ka parë nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ku është njoftuar me ecurinë e ndërtimit të urës. "Gjatë vërshimeve të këtij viti kemi pasur shumë dëme në rrugë

dhe ura, përfshirë edhe këtë pjesë të rrugës në fshatin Marali. Rrjedhimisht është rrezikuar edhe qarkullimi në këtë rrugë, e cila lidh shumë fshatra në këtë pjesë", ka thënë Berisha, duke shtuar se kjo urë do të ndërtohet shumë shpejt. "Punimet janë duke shkuar sipas planifikimit dhe shumë shpejt kjo urë do të ndërtohet dhe rruga do të jetë e sigurt për qarkullim", ka thënë Berisha.



Entrofia e fushatës zgjedhore, insufienca e një politike me premtime boshe (2)

Kujdes kujt po ia besoni votën!



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Partitë tona i dorëzuan listat për deputetë. Niveli i tyre profesional del se është aty kah Shkolla e Lartë Pedagogjike diku. E pse mos të dihet se janë 9 persona që dërguan në Hagë dosje kundër UÇK-së. E këtë luftë e ka bërë një parti "institucionaliste", sa që kur të zbulohen dokumentet, besoj se rinia dhe populli do t'i rrënojnë disa statuja, që janë ngritur për pedigree të atyre që aspirojnë frone faraonësh sot, e dje, pra postin e faraonit e synojnë nesër. E koha që (jo unë) do të botohen dokumentet nuk është larg, e atëherë dokumentet do të përmbysin çdo gjë, sepse ato dokumente kanë vlerë sekrete 25-vjeçare, disa 30-vjeçare, jo më tepër asnjë ditë. E dita e tyre kur mund të botohen është "ante portas". Pra, qytetarë të Kosovës, hapni sytë këtë herë, kushtrim: dilni në zgjedhje 80-90 për qind, atëherë do të dihet kush është mbrojtës i pavarësisë së Kosovës, kush është kreator i 2 korrikut, 7 shtatorit 1990, UÇK-së 1993-1999, të gjitha të arriturave dhe dështimeve deri më tash. Qëllimi im është, dështimet mos të përsëriten. Pse po rrefehem kështu?! Sepse një diplomat një ditë më pyeti: "Pse nuk po shkruan kur opinionin të lexon dhe të beson?! E do Kosovën. Pse nuk kandidohesh?" Ia prita me qetësi. Zotëri i nderuar, ju respektoj shumë, se jeni mik i shqiptarëve dhe i Kosovës posaçërisht. Ju jeni këtu një kohë të gjatë, skifterët e tjerë vijnë e shkojnë.

Në Republikën e Kosovës sot nuk ka rëndësi përgatitja shkollore. Këtu, në sajë të disa imponimeve me zarf e pa të që po bëni ju, që dordolecët të kanë funksione partiake dhe shtetërore për juve, janë të "ditur" dhe kush ma vënë veshin mua që nuk kam funksion partiak a shtetëror. E këta dordolecët, (jo ju besoj), më shumë i frikësoheni inteligjencës dhe diturisë sesa diplomacisë korruptive serbe dhe ushtrisë neofashiste miloshoshesheliste-vuçiste-daçiste...

sepse më në fund për fotele me ta e për ta, shumë shpejt e gjejnë pajtimin, e ju jeni kah ua bëni aminin këtyre marifeteve. Populli jonë këtë e di, prandaj nuk po voton, se vendosja po vjen nga lart-poshtë. Çdo gjë nën fotele, jo çdo gjë mbi ligjin, është deviza e popullit tonë sot, shumë inteligjent. Këta këto ligje nuk i njohin. E ata që kanë vjedhur e korruptuar dje e sot po na mbajnë ders moral, duke shkumuar: "Boll ma"! Filloi të qeshë me cinizëm, por i erdhi mirë që e njohim ku është plaga dhe cila është diagnoza. E ilaçi është shumë lehtë të gjendet, sepse ka "medikamente" që nuk janë "made in Kosova", si malli dhe taksa e Ramushit, që i tha stop pabarazisë, e ju për çdo ditë po na këshilloni, e vet herë i vëni taksa Kinës, herë Iranit e herë Ruisë, madje edhe BE-së. E ne nuk guxojmë të jemi sovranë? Tha: Po, keni të drejtë plotësisht, po mos premtioni kësaj radhe "bletë të bardha dhe rroga të Londrës e ekonomitë të Hon Kongut. Po shikoni, ju i keni 1 800 000 zgjedhës, ndërsa totali i popullsisë është 1 600 000. Këtu fshihet industria e dallaveve që do të përsëriten, nga të njëjtit aktorë".

E, zgjedhës të Republikës Kosovës, më 6 tetor 2019, ata që e votuan Gjykatën Speciale për t'i ndenjtur ajo mbi kokë si shpata e sulltanit, çdo ushtari të denjë të Adem Demaçit dhe Adem Jasharit - Legjendarit, Zahir Pjazitit dhe Adrian Krasniqit, duke u dridhur si thupra në ujën e akullit prej Brukselit me intriga të dr. Millan S. Protiqit, Dik Martit, Karlla del Pontës, A. Sorrosit, Xh. Bolltonit... le të dihet se kanë bërë tradhti historike morale, që gjyqi i historisë nuk ua falë kurrë, sepse e kanë sjellë Kosovën në një karantinë izolimi, sikur të kishte rënë këtu mortaja e shekullit gjashtë, që e kositi Ballkanin dhe jo vetëm këtë. Ku është qëllimi dihet, cili është mjeti, nuk shihet por, kuptohet! Po, duhet të dihet se shqiptarët një ditë sipas ideatorëve të nëntokës Llozanës, të inatosur, të mërztur dhe të varfëruar nga papunësia dhe padrejtësitë inovative evropiane, do të konvertohen, pse jo, të "aderojnë" në Listën serbiane dhe të gjithë do t'i kenë vizat gati, bile ato do të jepen

publikisht. Në vijim më kujtohen zgërdhirjet e LDK+PDK në Kuvendin e Kosovës për demarkacionin me Malin e Zi. Aty nuk pyetjesh kush ka fakte, por kush po ia bën qefin një personaliteti, që prej nënës e dija me fakte se ka prejardhje serbiane. E ai, kishte dëshirë që Kosova edhe për një metër katror të ngushtohet e lëre më për 8 500 hektarë tokë Kosove, den baba den. Kur ua tregova një dokument super sekret për Çakorin dhe Kullën publikisht, cinikët e dy partive simotra (PDK+LDK) në hajni e në dallavere, filluan të zgërdhien dhe të gjuajnë me fjalë. Nuk heshta, por u përgojova nga ai që më vonë u sëmure rëndë dhe tash ia ka mbathë shpatit dhe po teatizon e moralizon demokraci, duke e sha ish-ortakun e vet, që e bëri president, krejt lakuriq për ta zëvendësuar. E tash, jo ashiqare ia ka rezervuar vetes atë pozitë, sepse vetëm atë nuk e ka kullotur ende. E shteti nuk ndërtohet me hipokritë, e këtë maniometri infektive e dinin qysh në antikë: Sokrati, Epikuri, Talesi, Anaksagora, Dardaniani i Urtë, Dardani i Shpatës, prej të cilit mësoi cinizëm dhe satirë edhe Leka i Madh. Tani shikoni në TV se si një kandidat për kryeministër kërcënohet: "Bollë ma!", duke aluduar në PDK, se partia që i takon nuk ka kullotë që tridhjetë vjet djersën e Kosovës. Bile në luftë më shumë i ka sjellë dëme popullit të Kosovës me premtime dhe informata boshe sesa armiku me krime nga koha e Melkizekut.

Madje, kandidati në fjalë nuk e di se BE-ja e ka "zemrën e sëmure", ç'është pa kushtetutë dhe armiqtësisht në esencë është kundër Kosovës. Rasti i vizave nuk do koment. Po çka duhet të ndodhë më tepër se 2 milionë shtetas të Kosovës, që popullsia e Kosovës nuk është më e madhe se një lagje e Mynhenit apo Parisit. E në emër të kujt pra rrejnë liderët tanë politëknikë dhe politikë - kamikazë të Kosovës, se vizat nuk janë larg. Asnjë politikan i Republikës Kosovës nuk ka program ekonomik për 2, 4, 5, 10, 20 vjetët e ardhshëm, për ta nxjerrë Kosovën nga varfëria, e kur të krijojmë vende pune, askush nuk do të aspirojë të largohet. E vërteta, programi i zhvillimit ekonomik do të duhej të ishte i botuar si

libër publik. Pse rrejnë, do t'i hapim kaq mija vende pune, do ta luftojmë korrupsionin etj. Po ku mbeti komisioni i Atifetës dhe Hashimit për të "Vërtetën dhe pajtimin". Ne nuk i harrojmë miqtë e as humanizmin e tyre që na i kanë pranuar punëtorët tanë (1989-1999), sidomos Gjermania dhe Zvicra, që e kanë mbajtur gjallë familjen shqiptare në trojet e veta në Kosovë, sepse Milloshi kishte programuar shfarosje totale. Në rrethanat që janë krijuar, Ramush Haradinaj nuk ka pasur çare pa ua vënë taksën 100 për qind Serbisë dhe Bosnjës, sepse vetëm në këtë mënyrë kishte mundësi për ta prishur pazarin për ndarjen e Kosovës. Ramushi ka dhënë dorëheqje në anën tjetër, për ta zbuluar kush ka qenë i ftuar nga Gjykata Speciale dhe nuk i ka treguar popullit fare, ose aksioma tjetër, kush do të shkojë pas tij dhe ka funksion shtetëror, duhet të dorëhiqet. Ky kriter i Ramushit ia shton shansin për rizgjedhje, sepse është burror. Ramushi si e njoh, nuk është ndër ata pushtetarë që e gjuan gurin dhe e fsheh dorën. Vetëm ky ia ka zbuluar Frederika Mogerinit "rrenjën katrore" për të gjitha të palarat e "territ" për Kosovën. Kaq këtë herë.

Në anën tjetër do të ishte fatlumësi që Albin Kurti të zgjidhet kryeministër, sepse do të ndërpritej loja me fatin e Kosovës. Por, një fakt këtu është "terra in cognita", nuk dihet sa ka peshë në Uashington DC, sepse në Bruksel nuk ka askush, sepse duke e izoluar Kosovën, Brukseli po i bënë lajka ashiqare Moskës ku po lulëzon padrejtësia aristokrate me mizori intrigash masone. Në këto rrethana zgjedhore sidomos është përhapur një sëmundje kanceroze politike duke i anatemuar komandantët e UÇK-së dhe kjo dukuri po përsëritet pikërisht në çdo palë zgjedhje. Thua se këta jokomandantët janë evlia. Emri komandant është bërë në Kosovë gati simbol i urrejtjes, i përbuzjes dhe i së keqes, pikërisht prej disa pijanecëve gogolë, që gjithë ditën përgojnë nëpër kafene. Nuk them se të gjithë komandantët janë evlia, por të gjithë e kanë një të kaluar lufte dhe është dashur edhe ata të pakët që janë ta

dinë se nuk lejohet anarkia për askënd. Por duhet të dihet se është bërë i shtanguar dhe i paizoluar një mikrob infektiv, të cilin mikrob disa satelitë të errësirës infektive kanë filluar ta shprehin në çdo tubim. Ata me këtë propagandë po mundohen t'i grabisin adutët e luftës, fryteve të saj po u japin ngjyra politike, plagëve krenare të saj, gjakut arbëror të saj, faktorizimit të saj si model për popujt e shtypur e të robëruar, që të largohen nga robëria e ta fitojnë lirinë.

Po e devalvojnë vizionin dhe po e shndërrojnë luftën e shenjtë çlirimtare. Kritizimet e tillë janë në mision. E misionarët gati në të gjitha rastet e jetës në luftë janë legjionarë, profesionalë. Nuk po elaborojmë më tutje. E këtu janë fajtorë edhe disa dezertorë shqiptarë që janë kthyer pak a shumë prapë në luftën e drejtë, e ne i kemi pranuar si vergjinë veterane prapë prapë, sikurse Adem Demaçi që e kishte zemrën e pastër dhe më humane se Nëna Terezë, nuk ka ditur kurrë për urrejtje.

Pra, zgjedhës të nderuar të Republikës Kosovës, nëse doni të paktën t'u ndalet hovi të këqijave, dilni në zgjedhje 85-95 për qind. Vetëm atëherë demokracia do të lulëzojë, sepse as "komandantët" e as saboterët nuk janë UÇK, nuk janë Kosova e përgjakur, nuk janë populli. Unë nuk po e theksoj emrin e asnjë partie, ju zgjedhës e keni fjalën, fati i Kosovës është në votën tuaj, sepse kthim prapa nuk ka. Por nëse heshtni dhe pritni se do të vijë Amerika dhe do të na i zgjidhë problemet, e keni kot. Me politikanë injorantë dhe mendjemëdhën do të paguajmë haraç, do të paguajmë fajde që kurrizi do të na lakohet. Në fund e kam një porosi për të gjithë bartësit e listave, që në asnjë mënyrë mos të pranojnë ndryshim, korrigjim apo pasiguri të kufijve të Republikës Kosovës. E them këtë sepse jo vetëm të huajt, por as poseduesit e parave që janë shqiptarë nuk do të investojnë në një shtet të pasigurt, siç e kanë bërë negociatorët e Rambujesë, Vjenës dhe Brukselit. Bota kapitaliste investon vetëm aty ku shtetësia është ligjore dhe e sigurt.

Me nderime, kujdes kujt po ia besoni votën. Votoni.

(Fund)

#PDK112

Merita
Makolli

93

*Ndërtojmë të Ardhmen**Për Ty dhe Shtetin*

#PDK112

Shqiptar
Demaçi

55

*Ndërtojmë të Ardhmen**Për Ty dhe Shtetin*

E jashtëzakonshme

Policia kap 'mat' zyrtarin e lartë, i gjen 13.5 ton ar në shtëpi

Një zyrtar i lartë nga Kina ka për të dhënë disa shpjegime serioze pasi hetuesit gjetën 13.5 ton ar në shtëpinë e tij. Thuhet se vlera e tyre mund të jetë më shumë se 500 milionë dollarë. Bëhet fjalë për Zhang Qi, ish-kryetar i komunës dhe anëtar i Partisë Komunitare, i cili po hetohet për veprime të paligjshme dhe korrupsion. Pasi bastisën shtëpinë, oficerët e policisë gjetën mijëra ton arë dhe miliona



para si dollarë, juanë kinezë dhe euro. Përveç tyre, u zbulua se 58-vjeçari ishte pronar i disa vilave luksoze.

FOTO E DITES



Një dre shihet duke ecur i mbuluar nga mjegulla në Bjellorusi. /Reuters/

E rrallë

Gjahtarët paguajnë për foto me zebrat e vrara

Gjahtarët britanikë paguajnë që t'u jepet mundësia të vrasin edhe zebra të cilat rrezikojnë zhdukjen dhe që të krenohen me fotot në "Facebook". Shumë prej tyre paguajnë udhëtime në agjenci turistike që merren enkas me këtë punë. Endi Denson, një nga operatorët e kësaj agjencie, ka shpërndarë foto të zebrës së vrarë në faqen e "Facebook"-ut.



BARSOLETA E DITËS



I thotë mamaja djalit:
- Po more notë të keqe në provim nuk quhesh më pjesëtar i familjes...
Kur kthehet djali nga shkolla e pyet mamaja:
- Hë, si kalove sot?!
Djali:
- Njihemi gjë?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Do të ndiheni të fuqishëm sot, prandaj përdoreni këtë energji që të përfundoni disa projekte të rëndësishme.



DEMI

Ju mund të përfundoni shumë gjëra sot. Shfrytëzoheni në maksimum ditën e sotme.



BINJAKËT

Merrni kontrollin e vendimeve tuaja. Ju dini si të veproni në çdo situatë.



GAFORRJA

Ju do të përjetoni disa eksperiencia shumë intense sot. Ditë me fat për ju.



LUANI

Ju keni shumë energji sot, prandaj përdoreni atë në mënyrë konstruktive.



VIRGJËRISHA

Sot do keni mësimë të rëndësishme që duhet ti dëgjoni me kujdes.



PESHORJA

Sot duket se ka një atmosferë agresive rreth jush. Mundohuni që ju të jeni i qetë.



AKREPI

Fuqia nuk është pjesë e zakonshme e natyrës suaj, por nëse doni të largoni diçka nga jeta, sot është dita për ta bërë.



SHIGJETARI

Sot do keni fuqi të madhe në dorë, por mos e përdorni për keq.



BRICJAPI

Zhytuni brenda në vetvete sot dhe jepini botës pak nga shpirti juaj.



UJORI

Fjalët tuaja do kenë impakt të tmerrshëm sot, prandaj mendoni para se të flisni.



PESHQIT

Nëse duhet të bëni një punë serioze investigative, sot është dita e duhur.

Chris Martin mohon të jetë puthur me Dua Lipën



Këto ditë ka pasur thashetheme se Chris Martini është parë duke u puthur me Dua Lipën në skenën e festivalit Glastonbury, gjatë fundjavës. Por, 42-vjeçari, solisti i Coldplay, ka mohuar spekulimet se

ai ka puthur 23-vjeçaren. "Ne duam të konfirmojmë se Chris Martin dhe Dua Lipa nuk u puthën në Glastonbury dhe janë vetëm miq", ka thënë një përfaqësues i Chrisit në një deklaratë për "Daily Mail".

Edhe një këngë e re nga Camila Cabello



Camila Cabello ka paralajmëruar edhe një këngë të re. Këngëtarja 22-vjeçare përmes "Instagram"-it ka postuar një video të shkurtër me anë të cilës njoftoi se një

projekt i ri muzikor, pjesë e albumit të saj, vjen së shpejti. "Gotta go" ka shkruar ajo. Nëse nuk e dini, Camila së fundmi ka bashkëpunuar me Shawn Mendes.



Kit Harington del publikisht për herë të parë pas rehabilitimit

Kit Harington dhe gruaja e tij Rose Leslie u panë bashkë për herë të parë pasi aktori doli nga rehabilitimi. Ylli 32-vjeçar i "Game of Thrones" dhe 32-vjeçarja u panë duke ecur rreth rrugëve të Londrës, saktësisht në lagjen Soho. Muajin e kaluar u raportua se Kit

Harington ishte në rehabilitim për stres dhe alkool. Atëherë, Kit sapo kishte përfunduar një turne të madh shtypi për sezonin e fundit të "Game of Thrones". Kit dhe Rose, të cilët u njohën në setin e serisë më të famshme në botë, u martuan në fund të qershorit të vitit të kaluar.

Celine Dion ndryshon pesë herë veshjen brenda një dite në Paris



Celine Dion është duke e vizituar kryeqytetin francez për Javën e Modës. Por, këngëtarja 51-vjeçare duket se po e shfrytëzon kohën e saj në Paris edhe për ta shfaqur gjithë stilin e tij. Madje Dion

është parë duke ndryshuar pesë herë veshjen brenda ditës. Ajo ka ndryshuar veshjet fillimisht për një fotosesion derisa më vonë është parë edhe duke shëtitur me biçikletë në Kullën Eiffel.



Autor: GAZMEND MORINA	HEROINË SHQIPTARE IBE	AKTORJA ME FAMË BOTËRORE MILANO (shqip.)	FUTBOLLISTI FRANCEZ FRENK	ALTA VELOCIDAD ESPANOLA	KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE	E PËRZIEJ	ELEMENT KIMIK	BASHKËT.	VAJZA E BABAIT SULFUR, NEON	KLUBI FUTBOLLI NË ITALI (shq.)
VENDOS QË MË PËRPARA PËR TË BËRË DIÇKA (shq.)										
TË FIKËT								"T" para dy "N" TINGULLIMITIM		
LIRIDASHËSET PJESË QË I BIE DIKUJ (krah.)										
				Piktura kishtare Sëmudje që shkaktohet nga sasia e madhe e azotit në gjak					ZANORE KUNDREJT E SHITRENTJA	
MUZIKANTJA AMERIKANE DIOGUARDI					AIRDALE NETWORK OPS ELIZABETH TAYLOR				EDI RAMA OKSIGJEN, NIKEL	
URUGUAI		SHKRIMTARI SHEHU KËNGËTARI I FAMSHË BROWN (shqip.)					PJESË E LIMANIT PYLL			
DY BASHKËTINGËLLORE			OSMANI ERMELINDA MEKSI							QË SHFAQET SI MBETURINË E TRASHËGUAR NGA TIPARET E PËRAARDHËSVE TË LASHTË
EPOKA E RE	KËNGËTARJA AUSTRALIANE NË FOTO (shqip.)	ZONA E PËRHAPJES NATYRORE TË NJË GRUPI KAFSHËSH A BIMËSH	KAFENE, RESTORANT	GJENDJE E RËNDË E NJERIUT NË ÇASTET E FUNDIT TË JETËS	KËNGËTARJA NISHLIU	IRNOSET (bised.) FUTBOLLISTI FETAHU	IRONIA E HIDHUR RI NDESHIM (bised.)			
LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK E ME MUZIKË	◯					EMËR YNI MASHKULLI PËRHAPJE E VALËVE		"LOKEREN" LLOJ SHEQERKE		AGIM TEJECI MITROVICA
TRAJNERI SPANJOLL LUIS	◯					SHOK		PETRO MARKO PËRFUNDIM PA FITUES NË SHAH		ARMENIA ISH BASKET-BOLLISTI OBËRTINCA (shq.)
RILINDËSI DE RADA	◯					LETRARA MUSA	I ÇELE IMITUESE			DY BASHKËTINGËLLORE E BASHKUAR, E NJËSUAR
LLUKA ANTONINI	◯		AKTORI RAFUNA (shq.) SHUSHURIMA; GURGULLIMA				LLOJ PAPANALLI		NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË MBAJTJE E ANËS	
EMËR MASHKULLI MYSLIMAN	◯				ZANORE	KAMION I VOGËL KUNDREJT FETAR	DJALLËZOR (hebr.) BASHKËT.			
BREJTËSI I VOGËL	◯			MËNJANIM NGA GARA VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT				ARIANIT (perkdh.) KALORËS MESJETAR		KOMIKU I FAMSHËM ... CARREY (origj.)
ZANORE	◯	DY BASHKËTINGËLLORE BIMË, FIJET E SË CILËS PËRDORËN NË TEKSTIL			GURRË (sh.shq.) BASHKËT.		JAM I DENJË TË NDEROHEM ME NJË ÇMIM PERANDOR ROMAK			
FALJA QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT	◯					RAMADAN (perkdh.) RENNËS, ANGERS	PORTI DETAR QË TREGON VENDIN NË NJË RENDITJE SIPAS NUMRAVE			
SHENJË QË MENDOHET SE PARALAJMËRON DIÇKA	◯				GRYKË E VULLKANIT (sh.shq.) MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI				SHTËG I GJYMTË	
PJESËMARRJE NË NJË GARË	◯					QILIM I VOGËL QË SHTROHET ANËS VATRËT BASHKËT.		ARTIKULL I GJATË A STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK		NËPËR ARA, ARAVE. DREDHI QË BËHET PËR TË MASHTRUAR DIKË, DHELPËRI
EPOKA E RE	QË KA TRUP TË SHËNDOSH HAPËSIRË E MADHE UJI					BENDI MUZIKOR ".... MAIDEN" LLOJ, SOJ		RESHAT ARBANA ISLANDA		LLOJ DRURI ISH ATLEJTA MERLIN
GJOJA, KINSE						BASHKËT. "RODA"	FUTBOLLISTI HOLANDEZ VAN DER MEJDE NOTË MUZIKORE		MARRE DY BASHKËTINGËLLORE	
EVERTON		ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË BASHKËT.					DY ZANORE TREVISO	VDEKJEPRURËS ZANORE		
LLOJ REVOLUEJE			I TRASH A I PRISH TEHUN				QËLLOVE RASTËSISHT NË NJË NGJARJE			

Si e 'zhduku' ish- Bashkimi Sovjetik detin që dikur e kalonte me vështirësi Aleksandri i Madh




qetë. Më pas, gjërat u bënë të çuditshme. Peshqit u sëmurën dhe peshkatarët po ashtu. Përmbajtja e kripës ishte aq e


e ujit në botë, duke mbuluar një sipërfaqe prej 26,000 kilometrash katrorë. Aral (që përkthehet përafërsisht në

"Deti i Ishujve", i referohet qindra e qindra ishujve që dikur pikënisnin në ujërat e tij. Zona gjithashtu njihet për rritjen e frutave, tërfillit dhe elbit për bagëtitë.

Në vitin 2000, UNESCO paraqiti një plan 25-vjeçar për të rikthyer ujin në këtë rajon dhe në vitin 2005, Banka Botërore financoi pjesërisht një digë dhe gjysmë-rrjedhjen e një lumi në Detin Aral të Veriut. Sot uji po pikon qetësisht në atë që tani quhet deti Aral i Veriut dhe Jugut, aktualisht shtëpia e 24 llojeve peshqish. Një testament për fjalën e vjetër: Jeta gjen një mënyrë!?" (Dritare)



lartë në ujë, sa që në dekadat e ardhshme u bë e pamundur të zhyteshe në det pa u mbuluar nga një shtresë e madhe e bardhë. Dikur peshkatarët kapnin qindra peshq në ditë, ndërsa sot këto histori tingëllojnë si përralla për brezin e ri të vendasve që jetojnë në fshatrat buzë asaj që tashmë duket një shkretëtirë e madhe me anije të ndryshkura. Dhe ta mendosh që Aral, dikur ishte hapësira e katërt më e madhe



Vetëm 30 vjet më parë, ky vend ishte shtëpia e masës së katërt më të madhe të ujit në brendësi të planetit tonë. Një det i lashtë, aq i gjerë sa madje dhe Aleksandri i Madh shkroi për sfidat e tij për ta kapërcyer atë. Një det ku tregtia e peshkimit lulëzonte dhe pushuesit dikur vërshonin në qytetin e tij bregdetar të njohur për qendrat SPA. Tani, për herë të parë deti Aral është pothuajse i thatë. Ajo që arrin të shohë syri është thjesht një flotë e anijeve gjigande, të ndryshkura, të mbetura në fundin e tij, si provat e vetme të së kaluarës së lavdishme kur ato lundronin mbi ujë.

Nga deti Aral tani ka mbetur vetëm 10% e madhësisë që kishte në vitet 1960. Nëse mendoni se fajtor janë ndryshimet klimatike,

gaboheni. Kjo katastrofë mjedisore është vepër e njeriut, e konsideruar si një nga katastrofat më të rënda mjedisore ndonjëherë. Por historia nuk ka përfunduar ende dhe përkundër të gjithave, deti Aral është i mbushur me shpresë...

Por ju mund të pyesni; si ndodhi e gjitha kjo në një det aq të madh i cili shtrihej në dy vende euroaziatike, mes Uzbekistanit dhe Kazakistanit.

Ishte Bashkimi Sovjetik, ai që në vitet 1960 vendosi të zbatojë një projekt të madh të ujitjes së tokave bujqësore për industrinë e pambukut, duke devijuar disa lumenj kryesorë që ushqenin detin Aral, informon dritare.net Deri në vitin 1975, në këtë det mund të lundrohej pjesërisht



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Llapi fiton derbin ndaj 'Niklit', Dukagjini shijon fitoren e parë në Superligë

Fitore të rëndësishme në Drenas ka shënuar Llapi ndaj kampionit në fuqi, Feronikelit. Këto tri pikë e kanë ngritur skuadrën e Tahir Batatinës në pozitën e parë, kurse tri pikë të rëndësishme ndaj Ferizajt i ka arkëtuar Ballkani nga Suhareka. Fitoren e parë në elitë e ka shijuar Dukagjini, i cili e ka mposhtur Trepçën '89



EPOKA E ENJTE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 TETOR -Derbi i javës së tetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll i ka takuar Llapit, pasi ka arritur të mposhtë skuadrën e Feronikelit me rezultat 1-2. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll me epërsi të skuadrës mysafire, pasi Mentor Zhdrella realizoi në minutën e 41-të. Feronikeli nuk është dorëzuar dhe arriti ta barazojë rezultatit nëntë minuta para fundit nëpërmjet Mevlan Zekës, kurse rezultatit final e vulosi Mërgim Pefqeli që realizoi në minutën e fundit shtesë. Pas kësaj fitore i kënaqur është shfaqur trajneri i Llapit, Tahir Batatina, i cili ka thënë se Llapi e mposhti skuadrën më të mirë në Kosovë. "Feronikeli luajti mirë, por ne e kemi studiuar mirë dhe kemi punuar edhe në stërvitje për këtë lojë. Në pjesën e parë jemi mbrojtur më shumë, por shënuam gol me një aksion jashtëzakonisht të mirë, kurse në pjesën e dytë tentuam me kundërsulme të dalim në sulm, por pranuan gol nga ndërprerjet, gjë që kemi punuar shumë për këtë fazë, por që Feronikeli ka lojtarë të mirë në ajër si Kastriot Rexha. Ne kemi shënuar dy gola, por kemi mundur edhe më shumë. E merituan këtë fitore ndaj skuadrës më të mirë në Kosovë", ka thënë Batatina.

Pas kësaj humbje, Feronikeli bie në pozitën e tretë me 15 pikë, kurse Llapi merr kryesimin me 17 pikë. Fitore me rezultat 1-2 si mysafir ka shënuar edhe skuadra e

Ballkanit ndaj Ferizajt. Tre golat e shënuar u realizuan në pjesën e parë, kurse në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati. Për skuadrën nga Suhareka shënuar Blend Baftiu dhe Artur Magani, kurse golin e vetëm për Ferizajn e realizoi Edon Sadiu. Ballkani me tri pikët e fituara të mërkurën është ngritur në pozitën e dytë me pikë të barabarta me Llapin, kurse Ferizaj është në pozitën e dhjetë me 6 pikë. Fitoren e parë në elitë e ka shijuar edhe skuadra e Dukagjinit, e cila në ndeshjen e zhvilluar në Klinë doli triumfuese përballë Trepçës '89. Golin e vetëm e realizoi Husein Demiri në minutën e 40. Pavarësisht prej kësaj fitore, skuadra e Dukagjinit vazhdon të jetë e fundit me vetëm katër pikë, kurse '89-shi zë vendin e shtatë me nëntë pikë.

Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë

Dy ndeshjet e radhës në elitë zhvillohen sot (e enjte) nga ora 14:30. Në Gjilan, Drita e pret skuadrën e Vushtrrisë me synim për t'i arkëtuar tri pikët e reja dhe për ta vazhduar garën për kreun e tabelës. Ndërsa ndeshje shumë interesante do të zhvillohet në kryeqytet, ku Flamurtari, që po kalon nëpër një krizë rezultatesh, e pret Gjilanin. Edhe skuadra e fundit e ka humbur ndeshjen e fundit në derbi ndaj Dritës dhe tash synon t'u rikthehet fitoreve. Ndeshja në mes të Prishtinës dhe Drenicës është shtyrë për 16 tetor.

Malisheva e njofton Istogun me humbje

Skuadra e Malishevës e ka fituar derbin e Ligës së Parë ndaj Istogut (1-0) dhe në këtë mënyrë e ka marrë kryesimin në këtë rang garash. Golin e vetëm në derbin e javës së shtatë e shënoi sulmuesi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Nikoll Dushi. Në ndeshjen tjetër që është zhvilluar sot në Pejë, Besa dhe Trepça ndanë pikë duke luajtur 1-1. Ramiz Sadiku e mposhti Onixin (1-0), kurse Ulpiana triumfoi ndaj 2 Korrikut (1-2).

IPKO SUPERLIGA

Feronikeli - Llapi	1-2
Dukagjini - Trepça '89	1-0
Ferizaj - Ballkani	1-2
Të enjten takohen:	
14:30 Drita - Vushtrria	
14:30 Flamurtari - Gjilani	
Prishtina - Drenica, takohen më 16 tetor	

Tabela

1. Llapi	8	17 pikë
2. Ballkani	8	17
3. Feronikeli	8	15
4. Drita	7	14
5. Prishtina	7	13
6. Gjilan	7	12
7. Trepça '89	8	9
8. Drenica	7	8
9. Flamurtari	7	7
10. Ferizaj	8	6
11. Vushtrria	7	5
12. Dukagjini	8	4

LIGA E PARË

Vllaznia - Arbëria	2-4
Ramiz Sadiku - Onix	1-0
Malisheva - Istogu	1-0
2 Korriku - Ulpiana	1-2
Besa - Trepça	1-1
Të enjten takohen:	
Drenasi-Liria	
KEK-u-Vëllaznimi	
Vitja-Dardana	

Tabela

1. Malisheva	7	16 pikë
2. Istogu	7	16
3. Liria	6	13
4. Arbëria	7	13
5. Dardana	6	12
6. Besa	7	11
7. Trepça	7	11
8. Drenasi	6	9
9. Ulpiana	7	5
10. Onix	7	8
11. 2 Korriku	7	7
12. Ramiz Sadiku	7	7
13. Vllaznia (P)	7	6
14. KEK-u	6	4
15. Vitja	6	4
16. Vëllaznimi	6	3

SHKURT

Arrihet marrëveshja për miqësoren Kosovë - Kroaci

Gjatë qëndrimit në Kosovë presidenti i Federatës së Futbollit të Kroacisë, Davor Shuker, gjatë tërë kohës është shoqëruar nga ish-futbollisti ynë i mirënjohur, tani ndihmëstrajner i Përfaqësueses A, Muharrem Sahiti. "Përveçse evokuan kujtime të ligës dhe futbollit të atëhershëm, kur ata ishin yje në klubet e tyre, biseduan edhe për punën dhe rezultatet e të dy kombëtareve në vitet e fundit teksa u pajtuan edhe për zhvillimin e një ndeshjeje miqësore ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Data e zhvillimit të miqësore nuk është bërë me dije, por për një gjë të tillë do të vendosin kryetari i Federatës së futbollit të Kosovës dhe kryetari i Federatës së futbollit të Kroacisë.

Më 7 tetor dalin në shitje biletat e ndeshjes Kosova - Mali i Zi

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar opinionin se biletat për ndeshjen kualifikuese Kosova - Mali i Zi do të dalin në shitje më 7 tetor, në orën 16:00. Biletat do të shiten në platformën online www.tiks.app. Çmimet e biletave për veri dhe jug janë 5 euro, për lindje 10 dhe 15 euro. Ndërsa për perëndim 15 dhe 20 euro, e për zonën VIP çmimi është 80 euro.

Selimi: Nuk jam dorëhequr

Raportimet e fundit rreth dorëheqjes së Ramadan Selimit nga pozita e kryetarit të FBoxK-së i ka mohuar vetë Selimi. Kreu i Federatës së Boksit të Kosovës ka deklaruar për "SportPLUS" se do të tërhiqet përkohësisht për shkaqe personale. "Nuk jam dorëhequr, por vetëm është pezullim i përkohshëm i aktivitetit tim si president i Fboxk për shkak të angazhimeve private. I kam propozuar bordit që përkohësisht ta drejtojë Federatën nënkryetari aktual Sylejman Voca", ka deklaruar Selimi.

Rossi: Ky është piloti që do të dominojë në Moto GP

PARIS, 2 TETOR - Piloti francez Fabio Quartararo, që këtë sezon debutoi në Moto GP me Yamaha Petronas, do të jetë ylli i ri i këtij sporti. I këtij mendimi është një legjendë si Valentino Rossi, që e ka rival në pistë talentin 20-vjeçar.

Këtë sezon Quartararo ka seleksionuar tre "pole position" dhe në katër gara është ngjitur në podium. Ai mban rekordin e pilotit më të ri në Moto GP që siguron "pole" në histori (rekordi u vendos në pistën e Jerezit). "Quartararo

ka një talent të jashtëzakonshëm. E dija që ishte i shpejtë, e prisja këtë gjë, por jo deri në këtë pikë. Askush nuk e priste që ai të ishte rival. Nuk kursethet si gjatë provave të lira ashtu edhe në ato zyrtare e në garë", ka thënë Rossi. "Sa herë

që zbret në pistë është gjysmë sekonde më i shpejtë se rivalët. Dhe nëse ke të njëjtin motor si ai, duhet ta japësh maksimumin për të mos qenë pas tij. Duhet të punoj shumë, pasi është e bezdisshme ta kesh përpara", ka shtuar Rossi.



Amerikanët dominojnë në Botërorin e Atletikës



DOHA, 2 TETOR - Atletët amerikanë ishin dominues në ditën e pestë të Botërorit të Atletikës që po zhvillohet në Doha të Katarit, teksa fituan më shumë medalje të arta. Në garën e kërcimit me shkop për meshkuj medaljen e artë e fitoi Sam Kendriks, që kërcëu lartësinë 5.97 m, i ndjekur në vendin e dytë nga suedezi Duplantis po me 5.97 m, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi polaku Lisek me 5.87 m. Në finalen e hedhjes së shtizës për femra, kampione e botës u shpall australianja

Barber me 66.56 m, e ndjekur nga dy sportistet kineze, Shiyang Liu dhe Huihui Lyu, që u renditën respektivisht në vendin e dytë dhe të tretë. Në 800 m për meshkuj kampion bote u shpall amerikan Donovan Brazier me 1 minutë e 42 sekonda e 34 të qindtat, duke vendosur edhe një rekord të ri të kampionatit. Në vendin e dytë u rendit boshnjaku Amel Tuka, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi keniani Rotich. Dita e pestë u mbyll me finalen e garës së 200 m për meshkuj ku, ashtu siç pritej,

medaljen e artë e fitoi Noah Lyle i SHBA me 19.83 sekonda, duke lënë në vendin e dytë Andre De Grasse, ndërsa i treti u pozicionua ekuadoriani Quinonez. Pas ditës së 5 të botërorit, ShBA e sheh veten në pozita gjithnjë e më të konsoliduara në krye të renditjes në tabelën e medaljeve me 7 medalje të arta, 7 të argjendta dhe 2 të bronzta. Në vendin e dytë vazhdon të jetë Kina me 2 medalje ari, 3 argjendi e 3 bronzi, ndërsa e treta është Xhamajka me 2 medalje të arta dhe 2 të argjendta.

Federeri kujton duelin e parë ndaj Nadalit

CYRIH, 2 TETOR - Në vitin 2004, në raundin e tretë të turneut Masters të Miami, do të lindte një nga duelet më të mëdha të historisë së sportit, ai mes Roger Federerit dhe Rafael Nadalit. Në atë turne u zhvillua sfida e parë mes dy tenistëve (Nadali fitoi 2-0, 6-3, 6-3), një rivalitet që vijon ende sot në fushë, edhe pse kanë kaluar 15 vjet. Roger Federeri, duke kujtuar atë sfidë, shprehet: "Gjatë ndeshjes mbeta i habitur nga loja e Nadalit. E dija që do ta kisha të vështirë. Sapo kisha fituar në Indian Wells dhe nuk isha në formën më të mirë, pasi në finale kisha pasur probleme fizike". "Ndaj Nadalit nuk po arrija të gjeja një mënyrë për ta mundur, ishte e pamundur. Mbrohej mirë e kështu me radhë. Pas ndeshjes mendoja se do të triumfoje në Roland Garros një



herë, por kurrë se do të fitonte aty 12 herë. Pati një karrierë të jashtëzakonshme dhe për mua

ishte nder ta kisha në ekip në turneun e Laver Cup", ka deklaruar Federeri.

SHKURT

700 lekë çmimi i biletave për ndeshjen Turqi - Shqipëri

Federata Shqiptare e Futbollit njofton të gjithë të interesuarit se biletat e ndeshjes eliminatorë të "Euro 2020", Turqi - Shqipëri, do të fillojnë të shiten më 4 tetor në dyqanin e FShF-së. Kjo përballje e kuqezinjve do të zhvillohet më 11 tetor 2019, ora 20:45. Bileta kushton 700 lekë (rreth 6 euro) dhe një person mund të blejë deri në 5 bileta. Për blerjen e çdo bilete duhet të jepen të dhënat e mbajtësit të biletës si: emër/mbiemër/nr. pasaporte.

Allegri synon postin e trajnerit të Unitedit

Ish-trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, është i interesuar të bëhet trajneri i Manchester Unitedit, raporton "The Guardian". Raportohet se tashmë italiani ka filluar të mësojë edhe anglishten me Premierë Ligën si njërin nga destinacionet e tij të mundshme, e me "Old Trafford"-in destinacionin e tij të preferuar. Allegri është trajner i lirë që kur ishte larguar nga Juventusit në fund të sezonit 2018/19.

Juve dhe Barça në garë për Willianin

Juventusit është një nga ato klube të cilat në vitet e fundit ka bërë disa afrime me parametra zero. Dhe duket se bardhezinjtë do të vazhdojnë këtë traditë edhe gjatë merkatove vijuese. Siç raporton "Mundo Deportivo", Juventusit i ka hedhur sytë yllit të Chelsea, brazilianit Willian, të cilit i skadon kontrata në verën e ardhshme. Por, "Zonja e Vjetër" nuk do të jetë e vetme në garë për t'i marrë shërbimet e brazilianit, pasi është edhe Barcelona në lojë që ka kohë që po e ndjek lojtarin. Pritet me interes se ku pritet ta vazhdojë karrierën ylli i Chelsea, i cili ka fituar jo pak në Angli me "Blutë e Londrës". Kujtojmë që Willian është pjesë e Chelsea që në gushtin e vitit 2013, kur la Anzhin dhe shkoi në Londër për 35 milionë euro.

Leverkuseni mendon ta huazon Diabyn

Moussa Diaby u ble në verë për ta zëvendësuar Julian Brandt te Bayer Leverkuseni, por duket se gjërat janë shumë larg asaj që pritej për 20-vjeçarin francez. Ish-sulmuesi i Paris Saint Germainit nuk po përshtatet në një skuadër ku ka shumë konkurrencë, si te Leverkuseni, dhe ka luajtur vetëm 41 minuta në kampionat, teksa drejtuesit po mendojnë që tani ta zgjidhin këtë situatë. Diaby pritet të huazohet në janar në një ekip që i garanton vendin e titullarit e nuk përjashtohet edhe kalimi në Bundesligën II në ekipe të rëndësishme si Hamburg, Nuremberg apo Stuttgart.

Lloris: U dorëzuam shumë lehtë ndaj Bayernit

Ish-anësori i Arsenalit, Serge Gnabry, udhëhoqi kampionin gjerman drejt triumfit madhështor duke i shënuar katër gola shtatë golat e së martës mbrëma në "Tottenham Hotspur Stadium". Kjo ishte humbja më e thellë e Tottenhamit në shtëpi në një garë kaq të madhe. Disfata nënkupton se Tottenhami renditet i fundit në Grupin B me vetëm një pikë nga dy ndeshje dhe kapiteni Hugo Lloris thotë se skuadra nuk guxon të bëjë më lëshime. "Ndihej shumë keq për tifozët, kryesisht sepse ne u dorëzuam shumë lehtë dhe rezultati ishte edhe më i keq. Kjo është një natë që na prek shumë. Tani duhet të tregojmë karakter dhe ta harrojmë këtë. Dy ndeshjet kundër Crvena Zvezdës do të jenë edhe më të rëndësishme. Nuk guxojmë të humbasim pikë më", ka thënë Llorisi.

Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/ Skupština Opštine Dragaš/ Dragas Municipality
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik –
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine- Imovinska pravna sluzba -

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Shërbimi Pronësoro-Juridik, duke vepruar sipas Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.020-888 të dt.03.08.2019, me qëllim të shpronësimit për destinim të Varrezave të fshatit Brezne, Komuna e Dragashit, në lenden e shpronësimit 04.Nr. 465-1/2019 në bazë të nenit 8.5 të Ligjit për Shpronësim të Pronës së Paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshimet Ligjit nr.03/L205 të dt.28.10.2010 , me datën 26.09.2019 miraton këtë:

VENDIM

Vendimi për shqyrtimin e mëtejshëm të inicijativës komunale për shpronësim

1. **MIRATOHET** në shqyrtimin e mëtejshëm, Inicijativa e Komunës së Dragashit, sipas Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.020-888 të dt.03.08.2019, për shpronësimin e pronës së paluajtshme me qëllim të plotësimit të interesit publik, për shfrytëzim të pronës për varreza në fshatin Bezne, Komuna e Dragashit .

2.Lënda e këtij Vendimi është shpronësimi i ngastres kad. 01676-0 në tërësi, ZK Brezne , me kulturen livadha klasës 5, sipërfaqja 5286m², që ne elaboratin kadastral evindentohet ne emrin : Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3 , Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 dhe Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3, nga fshati Brezne.

3. Në afat prej 15 ditësh Organi për shpronësim e dërgon këtë Vendim së bashku me kopjen e Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.020-888 të dt.03.08.2019 dhe dokumentet tjera në Zyrrën për Vlerësimin e Pronës së paluajtshme e cila vepron në kuadër të Mnishtisë së Ekonomisë dhe Financave.

4.Në afat prej 10 ditëve, Organi i shpronësimit do të dërgon dokumentat palëve të cilat janë të theksuara në Vendimin e KK-së të Dragashit 01 Nr.020-888 , siç është paraparë sipas nenit 8.7 të Ligjit për Shpronësim,

5.Organi i shpronësimit, sipas kompetencave të veta, në harmoni me nenin 8.7 dhe nënpika 3.1, duhet të bëjë lajmërimin në të cilin do të përshkruhet qëllimi publik për të cilin është kërkuar shpronësimi, si dhe do të lajmëroj të gjitha palët e intereuara që kanë prona-pronarë të interesit, ose personat që pretendojnë në prona ose interesat, që mund të bëjnë komente me shkrim për shpronësimin e propozuar.

6.Po ashtu, Organi i shpronësimit do të lajmëroj të gjithë pronarët, zotëruesit të interesit dhe personat e interesuar për pronën, se do të mbahet diskutimi publik për shpronësim të pronës së paluajtshme ne vendin ku gjendet prona.

7.Në afat prej 10 ditëve, pas miratimit të këtij Vendimi, Organi i Shpronësimit do t'a shpall Vendimin në „Gazetën Zyrtare“ dhe në njerën nga gazetata me tirazh më të madh në Kosovë.

Organi për Shpronësim:
 Drejtoria Komunes- Shaban Shabani

07 Nr. Br. 464/11-26000
 1. 10. 20 19.
 Dragash - Dragaš

FTESË PËR OFERTM:

Në bazë të UA nga MASHT, me nr. 02/2016 të nenit 11, Këshilli Drejtues i Shkollës më dt. 18.09.2019 merr vendim:

T'u bëjë ftesë agjensioneve turistike për të aplikuar me oferta për ekskursionin e maturanëve të Gjymnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë

Ekskursioni do të realizohet në Shqipëri nga dt. 15.10 - 19.10.2019 me katër buajtje-pansion i plotë ku do të marrin pjesë 12-klasë me kujdestarë dhe rreth 404 nxënës(te regjistruar).

Për kushtet teknike të kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ dhe kërkesat e parashtruara nga KDSH, dosjen mund t'a merrni në zyrën e administratës së shkollës.

Aplikuesit duhet t'i plotësojnë kushtet sipas dosjes të cilën mund ta merrni në administratën e shkollës.

Oferta mbetet e hapur 7 ditë nga dita e publikimit.

Ofertat dorzohen në DKA- në Prishtinë

Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/ Skupština Opštine Dragaš/ Dragas Municipality
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik –
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine- Imovinska pravna sluzba -

NJOFITIM

Në bazë të nenit 8. paragrafit 7.3 të ligjit nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjin nr.03/L-205 datë 28.10.2010 dhe Vendimit të K.K. Dragasash 01nr.020 -888 nga datë: 03.08.2019, Organi për Shpronësim , në lenden e shpronësimit 04 .Nr. 465-1/2019 njoftohën të gjithë subjektet nga lista/tabela e cila është e bashkangjitur në njoftimin se:

1. Komuna e Dragashit sipas inicijativës së vetë, për arritjen e qëllimit të ligjshëm-publik për plotësimin e nevojave të qytetarëve të fshatit Brezne , ka inicuar procedurën e shpronësimit i ngastres kad. 01676-0 në tërësi, ZK Brezne , me kulturen livadha klasës 5, sipërfaqja 5286m², që ne elaboratin kadastral evindentohet ne emrin : Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3 , Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 dhe Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3 , nga fshati Brezne, për varrezat në fshatin Brezne, pas plotësimit të gjitha kushtëve të përcaktuara në parag.1 të nenit 4 të Ligjit nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 datë 28.10.2010, Kryetari i Komunës në zbatim të ligjit të lartpërmendur, ka miratuar Vendimin 02 nr .464/1-26060 Datë: 01.10.2019 me të cilin aprovoht shqyrtimi i mëtejshëm i inicijativës së Komunës së Dragashit për shpronësim, për qëllim publik të mëtejshëm të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga kjo iniciativ e shpronësimit për shfrytëzim të varrezave ne fshatin Brezne, zona kadastrale Brezne , sipas tabelës të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatsisht për titullaret e pronës të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të qëllimit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela praqesin pjesën përberse të këtij vendimi.

2. Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar mbi Ligjshëmërin e Shpronësimit të propozuar brenda 30- ditëve kalendarike, mbasë përmbushjes së kushtëve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjin nr.03/L-205 datë 28.10.2010 lidhur me organizimin e dëgjimit/ve publike.

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqes komentet e tij me shkrim lidhur me Shpronësimin e propozuar në organin shpronësues,brenda 10 ditëve kalendarike, pas shpalljes së vendimit të Kryetarit të Komunës ,për shqyrtimin e mëtejshëm të inicijativës për Shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një nga gazetata me tirazh të madhë në Kosovë.

4. Organi Shpronësues do të mbajë një dëgjim publik lidhur me qëllimin e shpronësimit të parcelës- lënda e procedurës së shpronësimit .

5. Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahët dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjëndet brenda kësaj komune ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo person i lartpërmendur do ti jepet mundësia e arsyeshme për ti shprehur mendimet e tij /saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafit 2 deri 4 të nenit 9 të ligjit nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjin nr.03/L-205 datë 28.10.2010.

7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shpreh mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, pronarit ose zotëruesit të interesit.

8. Dëgjimi publik lidhur me Shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në prona e paluajtshme, që ndodhën brenda juridikcionit territorial të Komunës së Dragashit, do të mbahët me datë: 18. Nëntor 2019 ora 9,30h në Sallën e Kuvendit Komunal.

9. Në rast se prona e cila është objekti i inicijativës për iniciimin e procedurës e shpronësimit , asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjin nr.03./L-205 datë 28.10.2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj ligjin për shpronësim me shënime si më lartë dhe të kërkoj ndihmë profesionale juridike në kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.

10. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim mënjehëre duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj,bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfardo dokumenti që ndërlihen me atë pretendim.

KRYETARI I KOMUNËS
 Shaban Shabani

REPUBLICA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragaš

02 Nr. Br. 464/11-26060
 01. 10. 20 19.
 Dragash - Dragaš

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/Dragas Municipality
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik -
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine- Imovinska pravna služba -

Direktorat za Urbanizam Katastar i Zivotnu Sredine – Imovinsko Pravna Sluzba postupajuci
po Odluci SO-e Dragas, 01 br.020-888 të dt.03.08.2019 god, radi eksproprijacije u svrhu seoskog
grobља u selu Bezna u predmetu 04 br. 465-1/2019 , na osnovu cl.8, stav 5, Zakona o Esproprijaciji
nepokretne inovine Br.03/L-139 sa izmenama i dopunama iz Zakona br.03/L-205, od 28.10.2010,
dana 26.09.2019 donosi:

ODLUKU
O dalnjem razmatranju opstinske inicijative za eksproprijaciju

- USVAJA se na daljnje razmatranje Inicijativa Opštine Dragas , za eksproprijaciju nepokretne imovine, na bazi odluke S.O. Dragash 01 br.020-888 të dt.03.08.2019, radi eksproprijacije u svrhu ostvarenja javnog cilja - obezbedjenje nepokretnosti-parcele za potrebe seoskog groblja u selu Brzna , Opština Dragas .
- Predmet ove Odluke je eksproprijacija cele kat.parcele 01676-0 ZK Brezna , po kulturi livada 5 klasae, površine 5286m2 , koja se na po 1/3 vodi na Aziz(Rakip) Krasniqi, Përparim(Rakip)Krasniqi i Lulzim (Rakip) Krasniqi svi iz sela Brezna
- U roku od 15 radnih dana telo za Eksproprijaciju ovu Odluku, zajedno sa kopijom svih drugih dokumenata dostavlja kancelariji za procenu nepokretne svojinu koji deluje u okviru Ministarstvu Finansije.
- U roku od 10 radnih dana telo za Eksproprijaciju poslaca dokumenta iz clana 8 stav 7 Zakona o Eksproprijaciji , indentifikovanim osobama cija imovina je u procesu eksproprijacije .
- Organ za Eksproprijaciju prema svojim ovlasćenjima, u skladu sa clanom 8, paragraf 7, podparagraf 3.1 mora da objavi obavestenje u kojem ce biti opisane javne namene za koje je zatrazena eksproprijacija, takodje ce obavestiti sva zainteresovana lica koja poseduju imovinu, vlasnici interesa, ili imovina kandidata, mogu da podnesu pisane komentare o predloženoj eksproprijaciji od strane organa za eksproprijaciju.
- Organ za Eksproprijaciju ce takodje obavestiti sve vlasnike, vlasnike interesa i kandidate za imovinu da ce odrzati javnu raspravu o eksproprijaciji nepokretne imovine tamo gde se nalazi imovina ili u prostorijama Opštine Dragas .
- U roku od 10 dana, nakon usvajanja ove Odluke Organ za eksproprijaciju ce objaviti Odluku u Sluzbenom glasniku i jednom od dnevnih novina sa najvećim tirazom na Kosovu

Organ za Eksproprijaciju
Predsednik Opštine:
Shaban Shabani
Shaban Shabani

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas
02 Nr. Br. 464/1-26000
01.10.2019
Dragash - Dragas

2

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/Dragas Municipality
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik -
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine- Imovinska pravna služba -


O B A V E S T E N J E

Na osnovu clana 8. Stav 7.3 Zakona br.03/L-139 od 26.03.2009 o eksproprijaciji nepokretne imovine sa uradjenim izmenama i dopunama Zakona br.03/L-205 od 28.10.2010, i Odluke Skupština Opštine 01 br.020-888 od dana: 03.08.2019 , od strane Organa za eksproprijaciju potvrđen navedenom odlukom , obavestava sve subjekte navedene u ovoj Odluci , da:

- Opština Dragas ,za postizanje javnog legitimnog cilja radi obezbedjenja potreba gradjana sela Brezna , radi obezbedjenja nepokretnosti za potrebe groblja u selu Brezna , u sprovođenju gore navedenog Zakona, Organ za Eksproprijaciju Opštine Dragas je usvojio Odluku 02br.464/1-26060 od dana01 .10.2019 o dalnjem razmatranju zahteva za eksproprijaciju nepokretne imovine vlasnika i posednika interesa koji se odnose na parcelu .01676-0 u celosti , KZ Brezna po kulturi livada 5 klase, površine 5286m2 , koje se u kat.elaboratu vode na ime : Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3 , Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 i Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3 , svi iz sela Brezna .
Predsednik Opštine ce doneti Preliminarnu Odluku o Zakonitosti predložene eksproprijacije, u roku od 30 kalendarski dana, posle ispunjavanja uslova određenih u clanu 9 Zakona br.03/L-139 od 26.03.2009 o eksproprijaciji nepokretne imovine sa izmenama i dopunama uradjenih u Zakonu br.03/L-205 od 28.10.2010, u vezi sa organizovanjem javnih rasprava.
- Svako za interesovano lice ima pravo da predstavi svoje komentare pismeno u vezi sa eksproprijacijom predložene Organa za eksproprijaciju, u roku od 10 kalendarski dana, posle proglašenja Odluke Skupštine Opštine br. 02br.464/1-26060 od dana01 .10.2019 , o dalnjem razmatranju zahteva za eksproprijaciju, u sluzbenim novinama Kosova i jednoj novini visokog tiraza na Kosovu.
- Organ eksproprijacije ce odrzati javnu raspravu u vezi eksproprijacije u vezi parcele koja je predmet inicijative za pokretanje postupka eksproprijacije za istu parcelu , za katastarsku zonu Brezna , Opština Dragas.
- Sva lica koju su javni sluzbenici Opštine u kojoj ce se odrzati javna rasprava ili vlasnici ili posednici interesa na imovinu koji se nalaze unutar ove Opštine ili advokati ili pravni zastupnici ovih lica, imaju pravo da ucestvuju na javnoj raspravi.
- Svako gore pomenutih licu pružice se razumna mogućnost da izrazi njegovo – njeno usmeno misljenje u vezi sa traženom eksproprijacijom u skladu sa stavom 2 do 4 clana 9 Zakona br.03/L-139 od 26.03.2009, o eksproprijaciji nepokretne imovine sa izmenama i dopunama uradjenih u Zakonu br.03-L/205 od 28.10.2010.
- Svako lice koji zeli da ucestvuje ili izrazi njegovo / njeno misljenje na raspravi, treba da donese svoje obrazložene dokaze (dokumente) koji dokazuju da je on – ona ustvari javni sluzbenik, vlasnik ili posednik interesa ili advokat ili pravni zastupnik tog javnog
- Javna rasprava u vezi sa traženom eksproprijaciji, privatnih prava ili drugih prava na nepokretnoj imovini, koji se nalaze unutar teritorijalne nadležnosti Opštine Dragas, odrzace se dana: **18. Oktobar 2019 u 9,30:00 casova u sali Skupštine Opštine Dragas .**
- U slucaju da imovina koja je predmet zahteva eksproprijacija posle zavrsetka procedure eksproprijacije pokrenute u skladu sa tim zahtevom, nijedna naknadna nece se isplatiti za troskove ili vrednost za bilo koje popravke uradjene na imovini , izgradnja ili prosirenje objekta na imovini ili sadjenom drvećem ili biljkama na imovini, od dana ispunjavanja relevantnih odredbi stava 8 clana 8 Zakona br.03/L-136 od 26.03.2009 o eksproprijaciji nepokretne imovine sa izmenama i dopunama uradjeni u Zakonu br.03/L-205 od 28.10.2010. Svako lice koje pretenduje da ima nekog vlasnickog interesa ili drugog pravnog interesa na relevantnoj imovinu savetuje se da razmotri Zakon br.03/L-139. Svako lice koji pretenduje da ima nekog vlasnickog interesa ili drugog pravnog interesa na relevantnu imovinu savetuje da razmotri Zakon za eksproprijaciju sa gore navedenim podacima i da trazi strucnu pravnu pomoc za razumevanje svog zakonskog prava.
- Svako lice koji nije navedeno u obavestjenju i koji tvrdi da ima vlastiti interes ili drugi pravni interes na biloj kojoj parceli nepokretne imovine opisane u obavestjenju odmah treba da dostavi organu za eksproprijaciju jedan opis njegovog / njenog pretendiranja, pravni osnov tog pretendiranja kao i overene kopije svakog dokumenta u vezi sa tim pretendiranjem.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas
02 Nr. Br. 464/1-26060
01.10.2019
Dragash - Dragas

PREDSEDNIK OPŠTINE:
Shaban Shabani
Shaban Shabani


Infrakos

Infrastruktura Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A publikon:

VAZHDIM KONKURSI

Duke u bazuar në vendimin e Menaxhmentit, Infrakos Sh.A njofton të gjithë të interesuarit se vazhdohet konkursi nr. 577/2 për vendet e punës

– Drejtues i lëvizjes së trenave praktikant dhe
– Ndërrues i binarëve praktikant

Vazhdimi bëhet edhe për tetë (8) ditë kalendrike duke filluar nga data e publikimit në mjetet e informimit publik gjegjësisht deri më 10/10/2019 në ora 16.00 min.

Konkursi bazë ka qenë i publikuar në të përditshmen Epoka e Re të datës 17/09/2019.

Aplikantët të cilët kanë aplikuar në konkursin e publikuar më 17/09/2019, nuk kanë nevojë të aplikojnë në VAZHDIMIN E KONKURSI, përveç nëse kanë nevojë për plotësimin e dokumentacionit ekzistues.

Arsyca e vazhdimit të konkursit është ofrimi i mundësisë që sa më shumë kandidatë të gjinive dhe nacionaliteteve të ndryshme të aplikojnë për punë në Infrakos Sh.A.

Për informata të tjera na kontaktoni në numrin e tel. 038 550 550 237.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. Pejë, 01.10.2019

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë, duke u bazuar në neni 12, pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, shpallë

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozila: Zyrtar për Bashkëpunim Ndërkombëtar- 1 (një vende punë)

Numri i referencës : UHZ-së /009/19

Lloji i pozitës: Jo i karrierës

Kategoria: P

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Drejtorit të Departamentit/Sekretari i Përgjithshëm

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- I përgatit propozim-marrëveshjet dhe protokollet për bashkëpunim ndëruniversitar ndërkombëtar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze;
- Bën përgatitjen e korrespondencës ndërkombëtare në gjuhë të huaja për rektorin, prorektorin për marrëdhënie me jashtë dhe për udhëheqësit e tjerë në Universitet;
- Sjell dhe shpërndan informata lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare ndëruniversitare;
- Ndihmon në krijimin e lidhjeve me universitetet e huaja, i këshillon profesorët në krijimin e këtyre lidhjeve;
- Mbledh të dhëna për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare në dispozicion për lëvizje të studentëve dhe të mësimdhënësve, si DAAD, EU, Fulbright, British Council, si dhe shpërndan informacione nëpër fakultete;
- Bën përkthimin e informatave gojariht ose me shkrim;
- Sipas udhëzimit të drejtorit, përcjell informata e raporte nga institucionet relevante ndërkombëtare për arsim, i kontakton universitetet për të iniciuar bashkëpunimin;
- Nëpërmjet drejtorit i përgatit materialet e Zyrës për marrëdhënie me jashtë për publikim në ueb-faqe;
- Mbledh të dhëna për fondet ndërkombëtare për bursa të studentëve dhe të profesorëve.
- Kryen punë të tjera të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës;

KËRKESAT / KUALIFIKIMET PROFESIONALE

- Diploma universitare, ose Master
- Kualifikimi, Juridik, Administrim Biznesi, Ekonomik, etj.
- 3 vite përvojë pune profesionale, pas diplomimit të dëshmuar me trust,
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo - shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Pejë, 2019



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Protokol. Br. Peç, 01.10.2019

Univerzitet "Haxhi Zeka" - Peç, baziran na osnovu člana 12, tačka 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova, Statutom Univerziteta, Uredbom br. 02/2010 o postupcima Zapošljavanja u državnoj službi, objaviti :

KONKURS

Za popunjavanje ovih slobodnih radnih mesta u Administraciji Univerziteta " Haxhi Zeka" u Peç-i.

Pozicija: Službenik za međunarodnu saradnju - 1 (jedno radno mesto)

Broj Protokola : UHZ- /009/18

Tip pozicije : Bez Karijere

Kategorija: P

Direktni nadzornik: Direktor Departamenta / Generalni Sekretar

DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI

-Priprema nacrt sporazuma i protokola o međunarodnoj saradnji na albanskom i engleskom jeziku;

- Priprema međunarodne korespondencije na stranim jezicima rektoru, prorektoru za vanjske odnose i drugim liderima na univerzitetu;

- Usvaja i distribuira informacije o međunarodnim međuuniverzitetskim odnosima;

- Pomaže u stvaranju veze sa stranim univerzitetima, savjetuje profesore u stvaranju tih veza;

- Prikupljanje podataka o nacionalnim i međunarodnim raspoloživih sredstava za kretanje učenika i nastavnika, DAAD, EU, Fulbright, British Council, i distribuira informacije fakultetima;

- Prevodi informacije usmeno ili pismeno;

- Pod uputstvu direktora, prati i izvještava informacije iz relevantnih međunarodnih institucija za obrazovanje, kontaktira univerzitete da pokrene saradnju;

- Preko direktora priprema materijala Ureda za međunarodne odnose za objavljivanje na web-stranice;

- Prikupljanje podataka o međunarodnim fondovima za stipendiranje studenata i profesora.

- Obavlja i druge poslove koje mu povjeri nadzorni službenik;

ZAHTEJEVI / STRUČNE KVALIFIKACIJE

- Univerzitetska Diploma ili Master
- Kualifikacija, pravo, poslovne administracije, ekonomije, itd
- 3 godine radnog iskustva u struci, dokazano s povjerenjem
- komunikacijske vještine u planiranju rada;
- Istraživanje sposobnosti, analitičke, evaluativna
- Sposobnost da ispuni zadatke i rade pod pritiskom;

OPĆE INFORMACIJE O KANDIDATIMA KOJI SE ODNOSI NA PROCEDURE KONKURSA

Kosovska Civilna služba garantuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

Ne - većinske zajednice imaju pravo na pravično i proporcionalne zastupljenosti u organima državne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br.03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova.

Kompletna dokumentacija dostavlja se u rektoratu Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peç, Ul. OVK. Bb, 30000 Peç, Republika Kosovo, u kancelariji za protokol.

Obrazac za prijavu možete preuzeti na (www.unhz.eu).

Konkurs ostaje otvoren 8 dana od dana objave u medijima.

Aplikacije dostavljene nakon roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Samo kandidati odabrani na kratkoj listi biće kontaktirani. Na proceduru prijama kandidata održace se testiranje i intervju kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa .

Peçi, 2019,

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

OFERTE PËR SHITJEN E PATUNDSHMËRISË

1. Sejdi (Sadik) Mackaj, me adresë në Prizren rr. "Xhevat Berisha" pn, është bashkëpronar me pjesën prej 1/4 e pjesës ideale (rreth 1611 m²), të patundshmërisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09490-1, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 6444 m², Zona kadastrale Prizren, si dhe me pjesën 1/4 e pjesës ideale (rreth 1945 m²), të patundshmërisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09490-2, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 7781 m², Zona kadastrale Prizren.

Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje tërë sipërfaqen prej 1/4 e pj. ideale të të dy ngastrave kadastrale (1611 m² + 1945 m² = 3656m²) patundshmërisë me të dhënat si me larte, në shumën e përgjithshme prej 24.000 E me shkronja: Njëzetë e katërmijë euro).

Prizren, 01.10.2019

Ofertuesi: Sejdi Mackaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Muradije Brovina shpall te pa vlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

► Besnik Nikaj shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Mjekësisë. "Hysni Zajmi" në Gjakovë.

► Sadije Sylja shpall të pavlefshme Diplomën e SHF "Azem Bejta" Shtuticë.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalitë me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



100%
KOSOVË
VOTO **119**

73

ELEONORA ÇEKU KRYEZIU
Kandidate për deputete në Kuvendin e Kosovës



#PDK112

**Lulzim
Shoshi** **68**